

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6005
E enje, 20 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

Meta fton qytetarët:
Më 2 mars besëlidhje
kundër grushtit të shtetit

I FAQE 2



FLET PËR "EPOKËN E RE", NEXHMI RUDARI

DO TË FITOJ PA BALOTAZH

Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Komunës së Podujevës, Nexhami Rudari, është shprehur i bindur se qeverisja e LDK-së në këtë komunë do të vazhdojë edhe pas 15 marsit. Në këtë intervistë dhënë për gazeten "Epoka e re", ai ka thënë se këto zgjedhje do t'i fitojë në raundin e parë. Rudari ka vlerësuar se elektorati i LDK-së në këtë komunë është stabil dhe nuk ka lëvizur. Sipas tij, forca e votuesve të LDK-së në Podujevë do të shihet ditën e zgjedhjeve. Rudari ka thënë se dy kundërkandidatët e tij, Shpejtum Bulliqin nga LV-ja dhe Naim Fetahuna nga PDK-ja, nuk i sheh konkurrentë në këtë garë pasi, sipas tij, atyre u mungon përvaja në qeverisjen lokale.



Cakaj: Kufiri Kosovë - Shqipëri duhet të hiqet menjëherë

Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë, Gent Cakaj, në një konferencë të përbashkët për media me ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka thënë se kufiri që ndan dy vendet tona është vetëm simbolic. "Ky kufi nuk duhet të ekzistojë fare. Duhet të hiqet menjëherë", ka thënë Cakaj. Ai ka bërë me dije se me Konjufcën kanë diskutuar për dy marrëveshje fillostarte ndërmjet dy vendave



Shkruan:
Enver
HOXHAJ

Putinizmi dhe rikthimi prapa i historisë (3)

I FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xhepcisht-Tetovë Curë-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

FALJET ÇLIRIMTARE F. 11

Ragip
SHALA



A DO TA BËJË ALBIN KURTI NDRYSHIMIN? F. 11

Perparim
AHMETI



AKTUALE

QEVERIA KURTI SHKARKON BORDIN E TELEKOMIT F. 5

QALAJ: MË SHUMË SE 100 POLICË KANË PROBLEME SERIOZE SHËNDETËSORE F. 2

EKONOMI

KURTI: DO TA ZËVENDËSOJMË TAKSËN 100 PËR QIND ME RECIPROCITET TË PLOTË TREGTAR ME SERBINË F. 9

KDI-JA: RRUGA E DUKAGJINIT, AUTOSTRADË APO ZGJERIM I RRUGËS EKZISTUESE?! F. 8

KULTURË

TENTATIVË PSIKOLOGJIKE PËR DEPËRTIM NË MENDIMIN E SHOQËRISË SË SOTME F. 14-15

Prof. dr. Kudusi LAMA

SPORT

KOSOVA E MOTIVUAR, KËRKON FITORE SONTE NDAJ ISLANDËS F. 20

Grenelli mohon se ShBA-ja mbështet shkëmbimin e territoreve

PRISHTINË, 19 SHKURT - I dërguari special i Donald Trumpit për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka reaguar ndaj një lajmi në të cilin thuhej se ShBA-ja ende është e hapur për shkëmbim të territoreve në mes të Kosovës e Serbisë.

Richard Grenell të mëkurën në

mëngjes, një raportim të tillë e quajti "lajm të rremë", ku i referohet "EU Observer"-it, i cili të martën publikoi artikullin. Në këtë artikull "EU observer" shkruante se "ShBA-ja po refuzon të përashtojë një shkëmbim të territoreve midis Kosovës dhe Serbisë - pavarë-

sist kundërshtimit të Gjermanisë ndaj kësaj ideje". "Lajm i rremë. Dhe, ju as që keni telefonuar apo shkruar për të pyetur. Unë jam për atë që pajtohen palët - jam i fokusuar në zhvillim ekonomik, jo në politikë", ka shkruar Grenell në llogarinë e vet në "Twitter".

Revista "EU Observer" shkroi se "Shtetet e Bashkuara edhe më tej janë të hapura ndaj planit për shkëmbimin e territoreve" në një tekst që përfshinte një intervistë me përfaqësuesin e posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Mathew Palmer.



Meta fton qytetarët: Më 2 mars besëlidhje kundër grushtit të shtetit

Presidenti Meta ka bërë me dije se më 2 mars në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" do t'i presë qytetarët në shesh për të lidhur një besëlidhje për ta shpartalluar regjimin e oligarkëve dhe shkatërruar bazën e krimit të organizuar kombëtar dhe ndërkombe.

TIRANË, 19 SHKURT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, në një konferencë përmes medie të mëkurën ka folur në lidhje me 'grushtin e shtetit' që po i bëjnë atij. "Vazhdojmë me prova të reja me përpjekje të gjysmëparlamentit për ta hedhur hapin final për grushtin e shtetit. Na thonë se kemi marrë mendimin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Komiteti do të sugjeronte që këto projektlige t'i nënshtrohen në konsultimi me presidentin e Republikës dhe ekspertë. Lidhur me këtë propozim, pra

për betimin te Lana-Komiteti vlerëson se ceremonia e betimit nuk mund të kryhet në mënyrë të shkruar, sepse betimi si akt i lartë që kërkon praninë fizike, gjithashtu sikurse dihet, që atributet që Kushtetuta i ka caktuar një organi, nuk mund t'i jepen një organi tjetër sic ven gjysmëparlamenti i deputetëve", ka thënë Meta. Ai ka thënë se akti i betimit duhet të bëhet para presidentit të Republikës. "Forma shkresore që propozohet me ligjin antikushtetues, përvëce se nuk është tipike, shmanget një



kompetencë ekskluzive që Kushtetuta ia ka akorduar presidentit të Republikës. Akti i

betimit nuk mund të jetë krejtësisht formal dhe duhet të kemi në konsideratë se

presidenti mund ta refuzojë ceremoninë e betimit nëse ai nuk e konsideron në përputhje me Kushtetutën dhe kur këto konflikte krijojnë mund të zgjidhen duke vënë në lëvizje organe të tjera si Gjykatën Kushtetuese", është shprehur Meta.

Më tutje, presidenti Meta ka bërë me dije se më 2 mars në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" do t'i presë qytetarët në shesh. "Më 2 mars do të lidhim një besëlidhje për ta shpartalluar regjimin e oligarkëve. Më 2 mars të gjithë bashkë në bulevardin 'Dëshmorët e Kombit'. Do ta shkatërrojmë bazën e krimit të organizuar kombëtar dhe ndërkombe. Ata që kërkojnë popullin e presidentit në 'WhatsApp' të porosisin poture të gjëra", ka deklaruar Meta.

Qalaj: Më shumë se 100 policë kanë probleme serioze shëndetësore

PRISHTINË, 19 SHKURT - Drejtori i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka thënë se më shumë se 100 policë kanë probleme serioze shëndetësore dhe se ata janë duke marrë trajtim adekuat shëndetësor. Sipas tij, sëmundjet me të cilat përballen policët janë të natyrave të ndryshme, duke përfshirë edhe sëmundjet psikike. "Ne kemi mjaft kolegë që vuajnë nga sëmundje të

ndryshme, nga sëmundje të rënda, duke përfshirë edhe disa kolegë që vuajnë nga sëmundje psikike. Të gjithë janë duke u trajtuar në aspektin mjekësor", ka deklaruar Qalaj. Qalaj ka pohuar se përrastet në të cilat zyrtarët policorë kanë probleme të tillë shëndetësore, parashihen edhe masat siç është risistemimi në



pozita t'jera të punës. "Shumica prej tyre punojnë me detyra të lehtësuara, pa armë, pa

pajisje, mirëpo për shkak të moseksizmit të ligjeve adekuate ne duhet t'i mbajmë ata në punë dhe maksimalisht bëjmë përpjekje që t'i sistemojmë aty ku ata mund të kryejnë ndonjë punë dhe ta ndiejnë veten se janë pjesë e sistemit", ka thënë Qalaj. Drejtori i Policisë së Kosovës i bëri këto komente në Gjilan, në

një konferencë të përbashkët me ministrin e Punëve të Brendshme, Agim Veliu. I pyetur për rastin e së martës, ku një zyrtare policore dyshohet se vrah me armën e vet zyrtare nënë, babanë dhe dy vëllezërët e më pas edhe veten, Qalaj refuzoi që të japë detaje, duke thënë se rasti është nën hetim dhe se të gjitha detajet do të zbardhen nga prokuroria.

Ambasadorja Kim takon Metën, Ramën dhe Bashën

TIRANË, 19 SHKURT - Ambasadorja e ShBA-së në Tiranë, Yuri Kim, ka zhvilluar të mëkurën takime me presidentin Ilir Meta, kreun e qeverisë Edi Rama dhe kreun e PD-së, Lulzim Basha. Pas takimeve, ambasadorja e ShBA-së ka dalë me një deklaratë, ku vë theksin te ndihma ndërkombe përmët, menaxhimin e fondevë dhe respek-

timin e institucioneve dhe proceseve demokratike. "Sot u takova me kryeministrin Edi Rama, presidentin Ilir Meta dhe kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha, përmët diskutuan mbi zhvillimet e fundit dhe pritshmëritë e ShBA-së. Përsai i përkthet specifikisht, konferencës së donatorëve në Bruksel, ne besojmë se ajo pasqyron soli-

daritetin, mbështetjen dhe dëshirën e komunitetit ndërkombe përmët ta ndihmuar popullin shqiptar në përpjekjet e rindërtimit pas tërmetit. Diskutuan edhe përmët transparencë dhe llogaridhënie përgjatë gjithë këtij procesi. Përvëç konferencës së donatorëve, diskutova edhe përmët hapat e rendësishëm

që Shqipëria duhet të ndërmarrë në javët e muajt e ardhshëm, duke treguar pjekuri, respekt përmët institucionet dhe besim në proceset demokratike. Presim që udhëheqësit shqiptarë të sillen në mënyrë të përgjegjshme dhe përmët mirën e popullit shqiptar. Ne e sigurojmë popullin shqiptar se ne do të jemi aty përmët vëzhguar dhe



kontribuar", thuhet në mesazhin e ambasadores Kim, publikuar në faqen zyrtare të Ambasadës Amerikane.

Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë, Gent Cakaj, ka takuar në Prishtinë liderët shtetërorë të Kosovës

Cakaj: Kufiri Kosovë - Shqipëri duhet të hiqet menjëherë

Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë, Gent Cakaj, në një konferencë të përbashkët për media me ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka thënë se kufiri që ndan dy vendet tona është vetëm simbolik. "Ky kufi nuk duhet të ekzistojë fare. Duhet të hiqet menjëherë", ka thënë Cakaj. Ai ka bërë me dije se me Konjufcën kanë diskutuar për dy marrëveshje fillestare ndërmjet dy vendeve. "I kam propozuar z. Konjufca dy marrëveshje fillestare, e para që duhet të mblidhemi që të firmosim një marrëveshje për ndarje të shpenzimeve në një fushatë për lobimin e njohjeve të Kosovës. Marrëveshja e dytë është ajo për transmetimin e përvojave në procesin e integrimit evropian", ka thënë Cakaj

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 SHKURT - Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë, Gent Cakaj, ka qëndruar të mërkurën për vizitë zyrtare në Prishtinë. Pas takimit me ministrin e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, në një konferencë për media ka thënë se është tepër i nderuar që ndodhet në Prishtinë.

Cakaj ka falënderuar popullin e Kosovës për ndihmën e dhënë në rastin e tërmetit tragjik. Ai ka shtuar se kufiri Kosovë - Shqipëri duhet të hiqet menjëherë. "Jam tepër i nderuar që jam këtu në Prishtinë. Populli i Kosovës ka shfaqur një solidaritet që ka sfiduar edhe kufijtë e të besueshëm, institucionet civile e ushtarake kanë bërë një punë të pashembullt e qeveria ka dhënë një financim të vyer për rimëkëmbjen e Shqipërisë pas tërmetit. Kufiri që ndan dy vendet tona është vetëm simbolik. Ky kufi nuk duhet të ekzistojë fare. Duhet të hiqet menjëherë", ka thënë Cakaj.

Ai ka shtuar se me ministrin Konjufca trajtuan disa probleme që janë thelbësore për bashkëpunimin e mëtejshmë. "Me z. Konjufca trajtuan disa probleme që janë thelbësore për bashkëpunimin. E shprehëm gatishmërinë për zhvillimin e ambasadave të përbashkëta. Ne



gjithçka që është e mundur që të ketë marrëveshje konkrete që më pas t'i konkretizojmë. Raport tonë ekonomike e tregtarë duhet të përmirësohen. Prej që është vendosur taksa, shkëmbimet sa i përket Shqipërisë drejt Kosovës janë rritur 300 për qind, por kjo nuk ka ndodhur edhe anasjelltas, dhe kjo duhet të përmirësohet dhe duhet ta rregullojë", ka thënë ai.

Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, është pritur në takim nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti. Cakaj e ka uruar Kurtin për detyrën dhe i ka thënë se duhet të takohen më shpesh. Mediat janë lejuar të marrin vetëm pamje.

Presidenti Thaçi dhe ministri Cakaj flasin për koordinimin ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë

Edhe presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur në takim ministrin në detyrë për Evropë dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Gent Cakaj. Thaçi e ka falënderuar ministrin Cakaj për vizitën që i ka bërë Kosovës menjëherë pas festimit të 12-vjetorit të pavarësisë. "Liria dhe pavarësia e Kosovës ndërlidhen drejtëpërdrejt edhe me kontributin e Shqipërisë. Një kontribut ky i jashtëzakonshëm historik. Por, në të njëjtën kohë edhe tash në procesin e konsolidimit të shtetit tonë, të anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe njohjeve të reja, kërkohet një koordinim në mes të Prishtinës dhe Tiranës", ka thënë presidenti

Osmani: Bashkërendimi me Shqipërinë të jetë në funksion të fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës

Ndërkaq në takimin mes kryetares së Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, dhe ministrit në detyrë për Evropë dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, është biseduar për b a s h k è p u n i m i n ndërparlamentar, në funksion të forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës.

Osmani ka thënë se ndër synimet e kësaj legislature mbetet edhe anëtarësimi i Kosovës në disa mekanizma parlamentarë, në të cilat ndihma e Shqipërisë është e domosdoshme.

Ajo ka kërkuar nga Cakaj koordinim më të madh ndërmjet Kosovës e Shqipërisë për politikën e jashtme. Sipas Osmanit, nevojiten qëndrime të përbashkëta për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës.

Në këtë kontekst, Cakaj ka bërë me dije se në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet të dy shteteve është në plan bashkimi i disa ambasadave e konsullatave, të cilat, përvësje një shfrytëzim racional, do të përbëjnë edhe një mesazh politik.

Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan se bashkëpunimi ekonomik ndërmjet të dy shteteve nuk është në nivelin e duhur, duke u zotuar për t'i shmangur pengesat.

Kryekuvendorja Osmanit kërkoi heqjen e barrierave jatorifore për bizneset kosovare që operojnë në Shqipëri. Kurse ministri Cakaj, duke premtuar ndihmë në këtë drejtim, ka thënë se është koha për një momentum të ri në bashkëpunimin ekonomik ndërmjet të dy vendeve.

Në këtë takim është diskutuar edhe koordinimi për ta mbështetur diasporën shqiptare si dhe shkelja e të drejtave themelore të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanovc. Pala shqiptare i bëri ftesë zyrtare kryekuvendares Osmanit që në një të ardhme të afërt ta zhvillojë një vizitë zyrtare pune në Shqipëri.



FLET PËR "EPOKËN E RE", NEXHMI RUDARI

Do të fitoj pa balot

Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, është shprehur i bindur se qeverisja e LDK-së në këtë komunë do të vazhdojë edhe pas 15 marsit. Në këtë intervistë dhënë për gazeten "Epoka e re", ai ka thënë se këto zgjedhje do t'i fitojë në raundin e parë. Rudari ka vlerësuar se elektorati i LDK-së në këtë komunë është stabil dhe nuk ka lëvizur. Sipas tij, forca e votuesve të LDK-së në Podujevë do të shihet në ditën e zgjedhjeve. Rudari ka thënë se dy kundërkandidatët e tij, Shpejtim Bulliqin nga LV-ja dhe Naim Fetahun nga PDK-ja, nuk i sheh konkurrentë në këtë garë pasi, sipas tij, atyre u mungon përvoja në qeverisjen lokale.

**EPOKA
ERE** Muhamet KOçi

PRISHTINË, 19 SHKURT -

Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, është shprehur i bindur në fitoren e tij më 15 mars. Ai ka deklaruar se edhe në këtë mandat do të vazhdojë qeverisja e Lidhjes Demokratike të Kosovës në këtë komunë. Në këtë intervistë dhënë për gazeten "Epoka e re", Rudari ka thënë se pret që këto zgjedhje t'i fitojë qysh në raundin e parë. "Ne synojmë dhe do të përgatitemi që ta fitojmë këtë garë pa balotazh dhe ta vazhdojmë qeverisjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës në Komunën e Podujevës. Pra, presim që këto zgjedhje t'i fitojmë qysh në raundin e parë", ka thënë Rudari.

Ai ka vlerësuar se elektorati i LDK-së në këtë komunë është stabil. Sipas Rudarit, kushdo që mendon se ky elektorat ka lëvizur, gabon. Duke iu përgjigjur pretendimeve të kandidatit të LV-së për kryetar të kësaj komune, Shpejtim Bulliqi, i cili ka thënë se kjo komunë nuk është më bastion i LDK-së, Rudari ka thënë se forca e votuesve të LDK-së do të shihet më 15 mars. "Pretendimet e tij janë mendime të tij. Ajo që mund të them unë është se z. Bulliqi do ta provojë forcën e LDK-së tash në garën që do ta kemi më 15 mars. Do të shohë z. Bulliq se elektorati i LDK-së në këtë komunë do t'i qëndrojë besnik Lidhjes Demokratike të

Kosovës, kurse ai do të pretendoëj të marrë vota nga subjekti që e ka propozuar", është shprehur Rudari.

Kandidat i LDK-së për kryetar të kësaj komune ka thënë se dy kundërkandidatët e tij, Shpejtim Bulliqin nga LV-ja dhe Naim Fetahun nga PDK-ja, nuk i sheh konkurrentë në këtë garë. Rudari ka vlerësuar se atyre u mungon përvoja në qeverisje lokale. "Mendoj se kjo do të jetë lehtësim për mua sepse unë kam qenë bashkëpunëtor i ngushtë me z. Veliu gjatë kësaj kohe, qoftë si drejtor i Arsimit, qoftë për një vit e gjysmë si nënkyetar i komunës. Mendoj se do të jetë një lehtësim për mua ngaqë kam qenë i kyçur në të gjitha proceset dhe fazat e projekteve komunale. Meqenëse kam njojuri për të gjitha punët që janë kryer dhe ato që duhet të kryhen në Podujevë, kjo do të jetë një rrëthanë lehtësuese për mua", ka thënë Rudari.

"Epoka e re": Z. Rudari, jeni zgjedhur kandidat i LDK-së për kryetar të Komunës së Podujevës. Do ta kërkonit votën e qytetarëve të kësaj komune për vazhdim të punëve të qeverisjes aktuale apo menjë ofertë të re?

Rudari: Tash unë si pjesë e ekzekutivit, si nënkyetar i Komunës së Podujevës, jam i vetëdijshëm se të gjitha projektet për vitin 2020 janë të miratuar në Asamblenë Komunale në fund të vitit të kaluar. Kështu që, unë duhet të punoj për zbatimin e të gjitha projekteve që janë miratuar në Kuvendin Komunal për këtë vit.



"Epoka e re": Sa sfiduese do të jetë për ju ta pasoni Agim Veliun, i cili për disa mandate ka qeverisur këtë komunë?

Rudari: Mendoj se kjo do të jetë lehtësim për mua, sepse unë kam qenë bashkëpunëtor i ngushtë me z. Veliu gjatë kësaj kohe qoftë si drejtor i Arsimit, qoftë për një vit e gjysmë si nënkyetar i komunës. Mendoj se do të jetë një lehtësim për mua ngase kam qenë i kyçur në të gjitha proceset dhe fazat e projekteve komunale.

Meqenëse kam njojuri për të gjitha punët që janë kryer dhe ato që duhet të kryhen në Podujevë, kjo do të jetë një rrëthanë lehtësuese për mua.

"Epoka e re": Nëse fitoni, do të sillni ndonjë risi në qeverisje apo vetëm do ta vazhdoni logjikën qeverisëse të deritashme?

Rudari: Do të vazhdoj koncepti qeverisës i LDK-së në këtë komunë. Ndërsa janë disa gjëra që individë të ndryshëm në

institucione të ndryshme i bëjnë sipas karakterit dhe njojurive që kanë. Pra, mund të ketë ndryshime të vogla, por në vija të trasha do të jetë koncepti qeverisës i hartuar në programin qeverisës të LDK-së për këtë fazë.

"Epoka e re": Kandidat për kryetar të Podujevës kanë nxjerrë edhe LV-ja dhe PDK-ja. Cili është vlerësimi juaj për këta konkurrentë?

Rudari: Nuk i shoh si

azh

"Epoka e re": Kandidati i LV-së për kryetar të Podujevës, Shpejtim Bulliqi, beson se do të arrijë ta thyejë bastionin e LDK-së në këto zgjedhje dhe ta ndryshojë qeverisjen në këtë komunë?

Rudari: Pretendimet e tij janë mendime të tij. Ajo që mund të them unë është se z. Bulliqi do ta provojë forcën e LDK-së tash në garën që do ta kemi më 15 mars. Do të shohë z. Bulliq se elektorati i LDK-së në këtë komunë do t'i qëndrojë besnik Lidhjes Demokratike të Kosovës, kurse ai do të pretendojë të marrë vota nga subjekti që e ka propozuar.

"Epoka e re": Sa besoni se do ta arrini ta mbronit bastionin e LDK-së?

Rudari: Jam shumë i bindur se do ta mbrojmë, sepse qytetarët e Llapit i kanë parë të arriturat e qeverisës së LDK-së në këtë komunë, të cilat janë të prekshme. Kështu që, mendoj se ka ende shumë për t'u bërë, por elektorati i LDK-së në këtë komunë është stabil dhe ashtu do të jetë edhe në ditën e zgjedhjeve.

"Epoka e re": Cilat janë pritet e juaja më 15 mars? Do të fitoni pa balotazh?

Rudari: Ne synojmë dhe do të përgatitemi që ta fitojmë këtë garë pa balotazh dhe ta vazhdojmë qeverisjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës në Komunën e Podujevës. Pra, presim që këto zgjedhje t'i fitojmë qysh në raundin e parë.

"Epoka e re": E pritni mbështetjen e kryetarit të deritanishëm të komunës, z. Veliu, i cili tashmë është emëruar ministër i Punëve të Brendshme?

Rudari: Besoj se secili subjekt politik do t'i mbështesë kandidatët e vet. Sigurish së LDK-ja edhe prej qendrës do të më mbështetë mua. Ndërsa Lëvizja Vetëvendosje do ta mbështesë kandidatin e vet e PDK-ja të vetin.

"Epoka e re": Zgjedhjet lokale në këtë komunë, a do të ndikojnë në stabilitetin e koalicionit qendror në mes të LV-së dhe LDK-së?

Rudari: Mendoj se është mirë që në nivelin qendror LDK-ja është në bashkëqeverisje me LV-në, sepse kështu kanë votuar qytetarët e Kosovës në zgjedhjet e përgjithshme në tetor të vitit të kaluar. Pra, i është dhënë rasti ta qeverisë vendin opozitës së mandatit të kaluar. Kurse sa i përket qeverisjes lokale, mendoj se LDK-ja ka mundësi që sikurse në këto 20 vjet, e vetme të qeverisë dhe ta udhëheqë ekzekutivin e Podujevës.

konkurrentë sepse atyre u mungon bukur shumë përvuja në qeverisjen lokale. Unë kam pasur rastin të punoj edhe në institucione qendrore dhe në ato lokale. Pra, kam përvojën e duhur për ta drejtuar Komunën e Podujevës dhe kjo për mua do të jetë lehtësim, sepse e di se si funksionon qeverisja lokale dhe si zhvillohen procedurat. Ndërkohë dy kundërkandidatët e mi kanë shumë më pak njojuri në fushën e qeverisjes lokale.

Qeveria Kurti shkarkon bordin e Telekomit

Qeveria e Kosovës ka shkarkuar bordin e ndërmarrjes publike Telekomi i Kosovës. Në arsyetimin e këtij propozimi, ministrja e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Rozeta Hajdari, ka thënë se ky veprim është i domosdoshëm pasi që ndërmarrja në fjalë është në gjendje të rendë dhe ndodhet në prag të falimentimit. Po në këtë mbledhje Qeveria e Kosovës mori vendim që të shfuqizohet vendimi i qeverisë së kaluar përfitimet e ish-zyrtarëve pas përfundimit të mandatit të tyre

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka shkarkuar bordin e ndërmarrjes publike Telekomi i Kosovës. Vendimi është marrë në mbledhjen e rregullt të qeverisë që është mbajtur të mërkurën me propozimin e ministres së Tregtisë dhe Ekonomisë, Rozeta Hajdari, e cila ka thënë se ky veprim është i domosdoshëm pasi që ndërmarrja në fjalë është në gjendje të rendë dhe ndodhet në prag të falimentimit. "Ndërmarrja është në gjendje të rendë dhe ndodhet në prag të falimentimit. Konstatoj domosdoshmérinë e vendimit të menjëhershëm dhe i propozoj qeverisë që të shkarkohet bordi i ndërmarrjes publike të Telekomit", ka thënë ministra Hajdari.

Ndërkohë, zëvendëskryeministri Avdullah Hoti i ka propozuar ministres që të mblidhet Komiteti Ministror, pastaj të merret vendimi. Po ashtu, në mbledhjen e së mërkurës kryeministri Albin Kurti ka propozuar që sekretarët e përgjithshëm të prekura nga riorganizimi të dalin në listën tepricë. Kurti ka deklaruar se ministritë e prekura nga riorganizimi janë Ministria e

Jashtme, e Teknologjisë, e Financave, e Punëve të Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Ministra e Infrastrukturës. Gjithashtu, Betim Reçica është shkarkuar nga posti i sekretarit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit. Me propozim të ministrit të Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, sekretar i ri është emëruar Izedin Bytyqi. Propozimi i Abdixikut është votuar unanimisht në mbledhjen e Qeverisë. Po në këtë mbledhje Qeveria e Kosovës mori vendim që të shfuqizohet vendimi i qeverisë së kaluar përfitimet e ish-zyrtarëve pas përfundimit të mandatit të tyre. Kryeministri Kurti ka thënë se me këtë vendim do të zgjedhjet shpenzimet.

Themelohet këshilli organizativ për shënimin e "Epopesë së UÇK"-së

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për themelin e Këshillit Organizativ për shënimin e "Epopesë së UÇK"-së. Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti ka propozuar zëvendëskryeministrin Haki Abazi në krye të këtij këshilli. "Propozoj që të themelohet Këshilli organizativ për shënimin e 'Epopesë UÇK'-së në datat 5, 6 dhe 7 mars. Këshilli do të përbëhet nga zëvendëskryeministri i dytë, Haki Abazi, nga ministri i Mbrojtjes, Anton Quni me përfaqësues nga zyra e Kryeministrat, Komuna e Skenderajt, MPBAP-ja, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës etj. Gjithashtu, edhe një përfaqësim nga familja Jashari, si dhe nga Zyra e Presidentit, Kuvendit, OVL-UÇK-së, asociacionit dhe përfaqësuesve të OJQ-ve", ka thënë Kurti.



Putinizmi dhe rikthimi prapa i historisë (3)



**Shkruan:
Enver HOXHAJ**

Putinizmi ka të bëjë edhe me ambicjen përtakthyeshme prapa orën e historisë. Ai e kritikon Amerikën për rënien sovjetike. Që ShBA-ja paraqet diçka të rrezikshme e të paparashikueshme, duke rikonfirmuar pikëpamjet e tij mbi rendin ndërkombëtar, e të cilat në thelb janë ato të Luftës së Ftohtë. Përderisa në fund të viteve '80 dhe gjatë viteve '90 kishte një bashkëpunim në mes të Uashingtonit dhe Moskës dhe një mirëbesim në mes të Reganit dhe Gorbaqovit, Bushit & Gorbaqovit dhe Klintonit e Jelcinit, me ardhjen e Putinit në krye të Rúsies, kësaj do t'i jepet fund. Partneriteti do të zëvendësohet me rivalitet dhe në qendër të tij do të jetë Kosova. Ky rivalitet u pa gjatë negociatave në Vjenë për statusin e ardhshëm të Kosovës. Rússia gjatë viteve 2005-06 ishte përfshirë në këtë proces dhe kjo ndodhës së kuadër të Grupit të Kontaktit me shitet e tjera përendimore, po aq në Këshill të Sigurimit dhe në UNOSEK.

Brenda G8 disa herë amerikanët dhe shtetet më të mëdha të botës diskutuan me Putinin për rezultatin e negociatave, por nuk kishte ujdi. Kur procesi ishte në fazën finale, ndërmjetësi i OKB-së, Ahtisaari, propozoi pavarësinë e mbikëqyrur si planin gjithëpërfshirës dhe një zgjidhje të qëndrueshme. Moska nuk e pranoi dhe lëvizti nga qasja ambiguitive drejt refuzimit të plotë në Këshillin e Sigurimit dhe kudo tjetër. Por, qasja ndaj Kosovës ishte pjesë e një platforme më të gjërë.

Premisat e para të saj hasen në fjalimin programor të Putinit në Konferencën e Sigurisë në Munih në shkurt të 2007-s. Ajo përherë të parë, pa kurfarë retorike diplomatike, ai tregoi pikëpamjen e errët mbi rendin ndërkombëtar. Pasojat do të shihen më vonë. Duke folur për leximin e tij të rendit ndërkombëtar dhe sfidave të sigurisë, ai skicon një përkufizim interesant si "bota unipolare". Ajo "ka të bëjë me një situatë ku eshtë një qendër e autoritetit, një qendër e forcës, një qendër e vendimmarrjes". Thotë se "Eshtë një botë e cila ka një zotëri (master) dhe një sovran". Ai la të kuptohej se Rusia ishte e orientuar tradicionalisht drejt Azisë dhe jo Evropës. Ajo mund ta përdorë forcën ndaj vendeve në Evroazi për të ushtruar ndikim apo nënshtruar ato. Fjalimi, në

Perëndim, u pa si fillim i konfrontimit dhe ballafaqimit të ri dhe shumëdimensional. Në Rússia mori atributet si "profetik". Rjedha e "profecisë" sot është e dukshme, komplekse dhe serioze në Evropë e më gjérë.

Natyrisht se Putini u mor edhe me Kosovën, duke thënë se "nuk duhet të imponohet asnjë zgjidhje". Nëse kjo do të ndodhë, Rússia, si anëtare me të drejtë vetoje në KS të OKB, do ta kundërshtonte një gjë të tillë. Plani i Ahtisaarit u prezantua para KS, por asnjëherë nuk u vendos në rend dite për miratim. Negociatat shtesë edhe për tre muaj nën udhëheqjen e treshes - F. Wisner, W. Ischinger dhe A. Botsoan Harqenko nuk sollën asgjë. Putini kishte parasysh interesat e Serbisë por, mbi të gjitha, do ta përdorte Kosovën që ta manifestojë rivalitetin me shtetet përendimore dhe t'i sfidonë ato. Por, kishte edhe pritje të tjera.

Ai e dinte që negociatat shtesë nuk do të ishin frytdhënëse, por pritja ishte të përbushen dy caqe. Së pari, të prishej uniteti evropian sa i takon Kosovës, gjë që edhe ndodhi. Pastaj, shtetet e BRICS dhe vende të tjera me peshë do të krijonin qëndrime preliminare kundër propozimit të Ahtisaarit. Së fundi, një stërgjatje e procesit dhe shpalljes së pavarësisë do të ndikonte që qytetarët e Kosovës ta humbin durimin. Ndoshta do të shpërthente edhe dhunë e brendshme dhe me atë të humbej mbështetja për pavarësi para se ajo të shpalloj. Për muaj me radhë, nga vera e deri në dhjetor 2007, anëtarët e KS nuk arritën të gjenin ujdi dhe miratojnë propozimin e Ahtisaarit.

Përcajë dhe ndiko

Putin do të bëhet aktiv sidomos në javën e parë të shkurtit 2008, në ditët para shpalljes se pavarësisë. Qëndrimet publike të tij për Kosovën do të janë sistematike. Do të përsërisi sesi një akt i tillë do të ishte "illegal dhe imoral", duke mos përmendor që propozuesi ishte ndërmjetësi i OKB-së.

Kundërshtonte ashpër argumentin se Kosova eshtë sui generis, dhe e cilësoi një "irrenë", duke mos thënë asgjë për procesin dy vjeçar negociator të OKB-së. Ai akuzonte përendimoret se po "përdorin standarde të dyfishta", po e njohin pavarësinë e Kosovës por jo edhe rastet e tjera në botë. "Ata s'kanë menduar thellë për pasojat, se çfarë janë duke bërë. Në fund të ditës, ky eshtë një shkop i prethë në të dy anët, dhe ana e fundit do t'i kthehet prapa, e do ti i godet në fytyrë." Përtej metaforave dhe diskursit, e që me vonë Rusia do ta përdorë të njëjtin edhe për rastet te tjera, më të dëmshmet ishin veprimet.

Putinizmi synon të përcajë

bashkësinë ndërkombëtare në tema që lidhen me sigurinë dhe paqen. U mundua ta përcajë qasjen rajonale të vendeve të Ballkanit ndaj Kosovës. Madje tek përcarja e unititet evropian, ai arriti rezultate konkrete. Slovacia para se të shpalloj pavarësia do ta miratonte një rezolutë në parlamentin e saj duke kundërshtuar planin e Ahisaarit dhe epilogun e tij. Rumania do të shantazhohet nga Rússia me Transnistrin nëse do të bënte hapa drejt njoftes. Kërkonte edhe publikisht që BE-ja ta njohë Qipron Veriore duke krijuar pasiguri sa te Qiproja po aq edhe të Greqia.

Po ashtu, në kontinente të tjera, ishte në koordinim me vendet e BRICS dhe shtete tjera me peshë në rajonet e ndryshme, që ta refuzonin njoftjen e Kosovës. Shume vende u përdorën si kundërpeshë ndaj ShBA dhe BE, dhe kudo e krijoj bindjen se projekti i pavarësisë eshtë imponim i tyre. Kudo akuzon ato për sjelljen e tyre sa i takon Kosovës. Ato "po krijojnë një precedan të rrezikshëm dhe të tmerrshëm", me pasoja "jo vetëm për dekada, por për shekuj". Por, kush e përdori atëherë një precedan të tillë? Në prill të 2008, gjatë Samitit të NATO-s në Bukuresht, Putini u paraqit i përbashkët dhe i kujdesshëm. Tha se nuk do të "jemi histerik" sa i takon Kosovës. Foli gjatë përvendet qfinqe përreth Rúsies, duke treguar sesa ruse etnik jetojnë atje, dhe sesi ai e kuption ndjeshmërinë e këtyre vendeve për ta ruajtur sovranitetin dhe integritetin territorial të tyre. Nuk e krijoj përshtypjen më të vogël se ai kishte ndarë mendjen për një betejë afatgjate. Në fillim akuzoi ShBA-në dhe lidershipin gjorgjian përkrijimin e një situate të konfliktit të hapur mes Gjeorgjisë dhe Rúsies. Mandej, papritmas, Rússia në verën e 2008, pas një luftë të imponuar me Gjeorgjinë, okupoi territorë dhe njuhë entitetet si Abhazia dhe Osetia Jugore. Ishte vazhdimi e politikës së krijuimit të fakteve në terren, natyrisht përmes forcës.

Zbulimi i thelbit të të pasaktave

Një vit pas, gjatë debatit të GJND-së, qasja e Rúsies ra ndesh dhe atë në mënyrë radikale me sjelljen e ardhshme. Rússia pretendon para kësaj Gjykate se e drejta ndërkombëtare nuk i lejon Kosovës që ta shpall pavarësinë, sepse populli i saj nuk e ka të drejtën përvendetosje. Pranvera e 2014 dhe ngjarjet në Krimë dhe në Ukrainën lindore do ta nxjerrin gënjeshtarin e mirëfilltë brenda Putinit. U pa që vazhdimisht ka gënjyer me qëllime të caktuara për Kosovën dhe në shërbim të

ambicieve ekspansioniste ruse. Gjatë kësaj kohe, ai akuzoi shtetet përendimore se po ndërhyrin në Ukrainë, dhe se lëvizja e atjeshme qytetare për demokraci dhe orientim evropian, nuk ishte asgjë tjetër veçse "grushtet nga jashtë". Në mars të këtij viti, Putini përdori dhe keqinterpretroi Kosovën për të justifikuar aneksimin e Krimës. Në fjalimin e mbajtur para parlamentareve ruse me 18 mars, dy ditë pas një "referendum" në kushte të okupimit, Putini tha që situata në Krimë është e ngjashme me atë të Kosovës. Por, kësaj radhe foli më shumë përvendetosje, që t'i mbështetet katalonas me quajtën "histeri". Mirëpo, një ekip i verifikimit të fakteve nga BE dha shembuj konkret, duke konfirmuar me raste sesi media të caktuara me mbështetje ruse ishin një përlajme të rreme". Disa diplomaci dhe shërbime evropiane të inteligençës konfirmuan përsëri që Rússia synonte ta destabilizonte Spanjën dhe këtë po e bënte duke mbështetur separatistët katalonas me fushatë dezinformuese.

Publikisht dhe politikisht Putini ishte neutral sa i takon Katalonisë sikurse më parë, Skocisë. Putini ishte vërtetë i kujdeshëm për këto çështje të nxehja evropiane. Ai tha se "në asnjë mënyrë nuk dëshiroj që t'i shoh vendet evropiane që po dezintegrohen" dhe i takon "Spanjës të vendosë vetë sesi do të ekzistonj" dhe sesi do t'i zgjidhë "problemet me regionet, me Kataloni dhe në Veri".

Neutraliteti dhe predikimi

Predikimi i tij për neutralitet, shpejt do të zëvendësohet me sulm publik ndaj evropianëve për "standardet e dyfishta", një shtrembërim ky tendencioz në raport me gjendjen e brendshme të BE-së. Me një frazeologji hipokrite bënte dallimin se "ka luftëtarë të vlerësuar përvendetosje, dhe po ashtu ka separatist të cilët nuk mund t'i mbrojnë të drejtat e tyre". Evropianët e bënë këtë "për të kënaqur vëllanë e madh në Uashington duke ofruar mbështetje pa kushte për shkëputjen (sesionin) e Kosovës, dhe kështu duke provokuar procese të ngjashme në Evropë dhe në botë".

Pastaj shtronte pyetjen në mënyrë cinike: "A e kanë ditur përkarakterin e konfliktit e vjetra në Evropë? Ata e kanë ditur, apo jo? Mirëpo, de-fakto mirëpriten dezintegrimin e një numri të shtetave në Evropë...".

Pritja e tij ishte dobësimi i unititet evropian brenda BE-së dhe pas dështimit të referendumit skocez, Katalonia do ta godiste kohezion evropian në zemër. Një shkëputje e mundshme do të krijojë kaos dhe do ta vinte në pikëpyetje vetë BE-në sepse zinxhiri i ngjarjeve do ishte Jashtë çdo parashikimi. Tek disa parti populiste dhe qarqe ksenofobe në BE, frazat e tij se evropianët me mbështetjen e Kosovës përvendetosje kishin nxitor

ritjen e separatizmit brenda vetë BE-së, po haste në mirëkuptim. Edhe pritet e tjetër Evropën, që kanë të bëjnë me shndërrimin e demokracisë në autokraci populiste dhe me dobësimin e BE-së synojnë që të krijojnë një rend evropian sesi ai të vepron veç e veç me këto shtete dhe jo me BE-në dhe NATO-n si bashkësi politike, ekonomike dhe të sigurisë. Në doktrinën e Putinit vlen parimi, që nuk ka edhe shumë rëndësi se kush e krijon një fakt, por kush e përdor dhe përfiton. Ai është munduar që ta keqpërdorë dhe të përfitoj jo vetëm nga Kosova, por për ironi edhe nga Serbia. E keqinterpretoi edhe intervenimin e NATO-s mbi Serbinë. Duke portretizuar Serbinë si viktimit e pambrojtur. Pa potencial bërthamor për vetëmbrojtje, e paraqiti edhe regjin e Asadit në Siri, aleatin më besnik rus në Lindje të Mesme. Por, këtu e bën një ndërrim të roleve. Angazhimi ushtarak i amerikanëve dhe i evropianëve në Afganistan, në Irak, në Siri, Libi dhe tek vendet myslimanë i quan si "kryqezata" moderne. Si përfundim, Kosova nuk paraqet ndonjë temë të rëndësisë së madhe për Putinin, por ai e ka përdorur atë si një antitezë ndaj Perëndimit. Duke kultivuar me kujdes një rivalitet me shtetet perëndimore, ai në fakt ndërtori një fabrikë të rrenave në këto njëzet vite për Kosovën. Gjatë vizitës së fundit në Serbi, janar 2019, ai pranoi si dhuratë një qenë Sharri nga Aleksander Vuqiq. Cila ishte simbolika e tij, asnjëherë nuk u tha në media. Mund të imagjinohet se qeni i Sharrit është besnik dhe e ruan mirë perimetrin e shtëpisë, e ndoshta Putini "sovranitetin" e Serbisë, meqë Rusia mbeti për trembëdhjetë vite garancia e vetme për ta bllokuar anëtarësimin e Kosovës në OKB. Përtjeri raporteve Kosovë-Serbi dhe rolit të Ruseve, narracioni i Putinit për Kosovën dhe sjellja e tij e jashtme tregojnë se ai ka shkeltë drejtëndërkombëtar; pushtoi territorë të fqinjëve, ndërhyni në sovranitetin e tyre dhe interferoi në BE me qëllim që t'i destabilizonte këto shtete dhe rendin ndërkombëtar. Kur mendon përvendin e tij në histori, përvallim se çka mendojnë rusët sot, ai të shfaqet si një pasqyrë e rreme. Dhe nuk duhet menduar asnjëherë që kundërshtari mund të mendoj dhe veprojë në rrëthana të njëjtë në mënyrën e njëjtë sikurse e percepton. Sepse do të ishte një lehim i gabuar, meqë edhe bota e tij është një pasqyrë e rreme, ku pasqyron ngjarjet dhe vepron jashtë imaginatës. (Fund)



Perparim AHMETI

Ndryshimi politik është bëre, por kjo është vetëm një pjesë e ndryshimit e cila nuk ka shumë efekt në popull. Në Kosovë, me ardhjen e Albinit, është vendosur një standard i ri për pozitën e kryeministrat dhe të ministrave. Vjosa dhe Albini janë një gjeneratë dhe një standard i ri në politikën e Kosovës. Këtë fakt duhet ta marrin shumë seriozisht partitë opozitare nëse duan të ofrojnë kandidatë të ngjashëm në të ardhmen. Por, cilat janë ndryshimet që populli i pret në të ardhmen nga Qeveria e re? Ndryshimet e mirëpritura janë më tepër të karakterit ekonomik, zhvillimor dhe në sundimin e ligjit. Këto ndryshime ende nuk kanë ndodhur. Pra, pyetjes se a ka ndodhur ndryshimi, duhet t'i përgjigjemi me fjalën pjesërisht! Kryeministri i ri i ka të gjitha predispozitat ta bëjë ndryshimin që e ëndërronjë kosovarët, por do ta ketë shumë vështirë. Ndryshimet e tillë zakonisht nuk mund t'i bëjë një person apo një grup i personave nga kabineti qeveritar. Është iluzion të mendohet që të gjithë ministrat do të kenë sukses, te disa prej tyre sukses varet nga aftësia e tyre, kurse te disa të tjerë edhe nga shumë faktorë të tjerë relevantë. Në fushat si tregtia, financat dhe bujqësia, mundësia përsukses është reale dhe jo edhe aq e vështirë. Në fushat e tjera, edhe nëse ato udhëhiqen nga ndonjë "Superman", suksesi është përpos i vështirë, edhe i ngadalshëm. Arsimi dhe shëndetësia janë fushat ku kërkohet një punë tepër e madhe për ndonjë ndryshim shumë të vogël. Ata që mendojnë të kundërtën, ose nuk e njohin problematiken ose nuk kanë vizion se çfarë ndodh në këto dy fusha në botën e zhvilluar. Fushat me probleme mesatare dhe mundësi të zgjidhjes në afatin jo shumë të largët janë ato që lidhen me sundimin e ligjit. Por ku mbeti zhvillimi ekonomik??!

Për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik është e domosdoshme që të trajtohen problemet e lartës, fillimisht arsimi dhe sundimi i ligjit. Duke marrë parasysh se

Qeveria përmomentin përballet me një staf civil mjafë të politizuar dhe të dembeluar nga keqveverisjet e deritanishme, bashkëpunimi apo motivimi i tyre do të jetë shumë i vështirë. I mbetet Qeverisë që të mendojë për një program nacional të injektit të ekspertëve në shërbimin civil të Kosovës. Nëse arrihet kjo atëherë me të vërtetë mund të shpresohet për një ndryshim pozitiv për popullin e Kosovës. Nëse marrim parasysh nivelin arsimor në Kosovë, me siguri se nuk mund të gjemë shumë ekspertë për të kontribuar në këtë çështje. Mundësia e vetme mbetet te thithja e trurit nga diaspora. Mendoj se vetëm ata mund ta bëjnë ndryshimin. Këtu po mendoj për diasporën tonë të arsimuar dhe të suksesshme në Perëndim, jo për dajtë e tezet e politikanëve. Për shembull, me një kontingent prej 100 ekspertëve nga diaspora, duke i shkuar edhe disa nga ekspertët e nacionaliteteve të tjera, por të përzgjedhur nga Qeveria, mund të bëhej një bum jo vetëm në aspektin zhvillimor, por edhe në atë social e shoqëror.

Diaspora jonë do të lidhej edhe më ngushtë me Kosovën dhe do t'i jepte një puls të ri besimit për investime nga jashtë e sidomos nga vetë diaspora. Por, diaspora nuk sillet në Kosovë me patriotizëm e populizëm. Atë mund ta sjellim me kushte të mira të punës dhe respekt human. Pra, Qeveria Kurti nuk e ka luksin të mendojë gjatë për strategji monotone. Ajo duhet të tregohet më radikale dhe e guximshme në vendimet dhe veprimet e ardhshme. Të gjitha këto janë dëshira, të cilat sigurisht nuk janë të lehta për t'u implementuar. Z. Kurti e ka vështirë që në të njëjtën kohë të merret me tarifën, dialogun, politikën e brendshme etj. Ai si kryeministër për çdo ditë ka aktivitetë të ndryshme politike dhe takime të panumërtë, andaj duhet menduar më tepër për problemet sipërfaqësore që u ceken e të cilat kanë efekt direkt në shoqëri. Politika një ditë duhet të merret edhe me problemet e vështira siç janë universitetet private e publike, prokuroritë dhe gjykatat, por

shumë esenciale edhe çështja e pronave dhe kadastrës. Kosova ka nënshkruar një marrëveshje me Serbinë për kthimin e dokumentacionit kadastral. Shtrohet pyetja, çfarë do të ndodhë kur të dalin pronat e keqpërdorura në 20 vjetët e pasluftës si "kungulli mbi ujë". A e di shoqëria e Kosovës që më pak se 10 për qind e pronarëve faktikë i kanë pronat në emrin e tyre. A e di shoqëria e Kosovës se sa konteste pronësore janë nëpër gjykata që s'mund të marrin një epilog për arsyet e mosfunkcionimit të sundimit të ligjit dhe vendimeve të tjera ekzekutive. Këto që i përmenda më lart janë disa probleme që, ndoshta, kryeministri është mirë mos t'i dijë fare. Por, përparësia e z. Kurti në këtë problematikë të pronave dhe kadastrës është që ai nuk ka gisht në asnjë skandal që lidhet me to dhe, si rrjedhojë, do ta ketë më lehtë trajtimin e tyre dhe s'ka ndonjë hipotékë për trajtimin e dokumenteve kadastrale të ardhura kohët e fundit nga Serbia.



KDI-ja: Rruga e Dukagjinit, autostradë apo zgjerim i rrugës ekzistuese?!



PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Analiza e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) në tryezën e së mërkurës kishte për qëllim të vlerësonte nëse vendimi i qeverisë së kaluar lidhur me investimin kapital "Autostrada e Dukagjinit" reflekton prioritetet dhe nevojat e qytetarëve të saj dhe nëse është i përballueshëm për kuletën e shtetit.

KDI tenton të hedhë dritë mbi këtë proces planifikimi dhe të analizojë se si ky projekt arriți të devijojë nga projekcionii filletar për zgjerimin e rrugës ekzistuese në projekt për Autostradë.

Gjatë elaborimit të gjetjeve kryesore, Fjolla Uka nga KDI-ja ka theksuar se vendimit të qeverisë për projektin e autostradës së Dukagjinit nuk i kishte paraprirë një studim i fizibilitetit dhe një analizë e kostove dhe përf-

fitimeve, të cilat, sipas saj, do të mbështhesnin vendimin për ridestinimin e projektit, nga zgjerimi i rrugës ekzistuese në autostradë. "Për më tepër, ky investim nuk ishte paraparë në dokumentet strategjike si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Plani i Qeverisë 2017-2019. Këto dokumente mbështesin vetëm rikonstruimin e rrugës ekzistuese Istog - Pejë - Deçan - Gjakovë - Prizren (R-107)", ka thënë Uka.

Sipas KDI-së, jetësimi i këtij investimi do të mund të ndikonte negativisht në fusha të tjera me prioritete të parapara me SKZH, si arsimi, shëndetësia, sundimi i ligjit e punësimi. Sa për ilustrim, kostoja reale në raport me përfitimet e planifikuarë në autostradën "Arben Xhaferi" ka treguar se ky investim ka pasur

kosto më të lartë sesa përfitimet. Edhe ndërtimi i Autostradës së Dukagjinit, e parashikuar të kushtojë mbi një miliard euro, do të mund të prodhonte efektet e njëjtë.

Ali Berisha, deputet i Kuvendit të Kosovës nga subjekti politik AAK, ka arsyetur këtë vendim të qeverisë me nevojën e investimeve në zonën e Dukagjinit që ka rrëth 600 000 banorë dhe me konsultimet publike që janë mbajtur në këto komuna. Ai ka vlerësuar se studimi është i vonuar dhe kthimi në projekcionin për zgjerim nuk është i qëndrueshëm. Sipas tij, cenimi i këtij projekti është i dëmshëm për zhvillimin ekonomik të kësaj zone.

Betim Reçica, sekretar në Ministrinë e Infrastrukturës, duke mbështetur ndërtimin e autostradës në rendësinë e lidhjes

së rajonit me korridoret evropiane, ka thënë se nëse ky investim ndahet në segmente, nuk do të ndihet mungesa e investimeve në fusha të tjera prioritare dhe nëse do të menaxhohej mirë, nuk do të kishte efekt negativ në borxhin publik.

Hajrullah Çeku, deputet i Kuvendit të Kosovës nga LV-ja, ka thënë se ka përpjekje që lidhur me këtë projekt të krijohet sentimenti anti-Dukagjin, ndërsa ka theksuar se megainvestimet si ky, ndonëse të nevojshme, duhet të janë rentabile. Ai vuri theks edhe në ndikimet mjedisore, sociale e kulturore që mund të sjellë ndërtimi i autostradave.

Ferat Shala, deputet i Kuvendit të Kosovës nga PDK-ja, ka theksuar se shkalla e kthimit të investimeve nga autostrada nuk është vetëm financiare, por edhe kulturore e

sociale. Ai lidhi ndërtimin e saj me zhvillimin e turizmit në zonën e Dukagjinit dhe shtimin e sigurisë rrugore.

Përfaqësuesi i Këshillit të banorëve të Rahovecit, Suad Çmega, përsëriti se MI-ja kishte ndërruar variantin e trasesë fillestare së autostradës në diskutimin e tretë publik me të cilin nuk ishin pajtuar banorët e Rahovecit, pasi që kryja në autostradë ishte shumë larg. Ai, po ashtu, përmendi mbledhjen e 10 000 nënshkrimeve për të kundërshtuar këtë variant që nuk ishte marrë parasysh.

Shumica e të pranishmëve theksuan nevojën për depolitizim të debatit, ndërsa konfirmuan që për këtë projekt nuk kishte një plan të mirëfilltë fizibiliteti, e i cili është i domosdoshëm për vendimtarje strategjike lidhur me investimet kapitale.

AKP-ja shpalli rezultatet e shitjeve përmes likuidimit nr. 54



PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) të mërkurën në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjes së aseteve përmes metodës së likuidimit nr. 54 shpalli çmimet më të larta të ofruara për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje. Për 93 asete sa ishin në shitje konkurruan 91 ofertues, ndërsa vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 2,254,33 euro.

Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente, para përfaqësuesve të medave, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm, ndërkohë është bërë transmetimi i drejtpërdrejtë i ceremonisë përmes faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është e shtrirë dhe vpron në të gjithë territorin e vendit. Agjencia ka mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve investitorëve private-blerësve, ose likuidimin e tyre, gjithnjë përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

KRU "Hidrodrini" kërkon nga konsumatorët që t'i paguajnë detyrimet financiare

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Hidrodrini" u ka bërë thirrje konsumatorëve shtëpiakë, komerciale dhe industrialë, të zonës së saj të mbulueshmërisë

në komunat Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik, që t'i kryejnë obligimet financiare të faturuara. Në të kundërtën, kjo kompani ka paralajmëruar se mbetet e detyruar të aplikojë masa të cilat

do të rezultojnë me shkyçje individuale të konsumatorëve borxhlinj, padi gjyqësore dhe proces ligjor te përmbaruesit. KRU "Hidrodrini" në këtë adresim theksion se me

shërbimet e shtrirjes në komunat e sipershënuara, mbetet ndër kompanitë më serioze dhe precise e profesionale në furnizim me shërbime për konsumatorë.



Kurti: Do ta zëvendësojmë taksën 100 për qind me reciprocitet të plotë tregtar me Serbinë

“Tarifa ka qenë vendim i qeverisë së kaluar. Ne nuk jemi për tarifa si masë ndëshkuese ndaj konsumatorit, por për reciprocitet si masë mbrojtëse ndaj prodhuesve”, ka thënë kryeministri Albin Kurti në edicionin e dytë të Konventës së Prodhuvesve të Kosovës, organizuar nga Klubi i Prodhuvesve të Kosovës

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë të mërkurën në edicionin e dytë të Konventës së Prodhuvesve të Kosovës, organizuar nga Klubi i Prodhuvesve të Kosovës. Duke folur para të pranishmëve, kryeministri Kurti ka thënë se, përkundër vështirësive dhe pengesave të shumta me të cilat përballen ata, e që janë të shumta edhe në numër edhe në lloj, kanë vendosur që të investojnë dhe të punojnë në Kosovë. “Nga unë si kryeministër dhe nga qeveria që unë drejtoj ju do ta keni vëmendjen maksimale, prandaj pres që edhe nga kjo konventë të dilni me rekomandime të cilat ne do t'i kthejmë në veprime konkrete”, ka thënë ai, derisa ka veçuar se prodhuesit tanë janë edhe shtylla e shoqërisë, jo vetëm e ekonomisë. “Do të sigurojmë një ambient të barabartë duke hequr monopolet, duke eliminuar evazionin fiskal, por edhe duke siguruar furnizimin me energji elektrike me çmim të përballueshmë. Pra, së pari, do të bëjmë veprime me të cilat e nivelojmë garën sepse një biznes nuk mund ta rrisë prodhimin nëse operon në kushte të pabarabarta në treg. Pabarazia të dekurajon për garën. Do t'i identifikojmë sektorët më potencial të rritjes së prodhimit e rrjedhimisht të punësimit”, eshtë shprehur Kurti, duke shtuar se “ju keni vite që më keni thënë se ajo që ju mungon eshtë konkurrenca fer dhe mungesa e qasjes në financa, sepse idetë dhe inovacionin i keni. Tash erdhë dita që t'i bëjmë këto të dyja: edhe t'i heqim monopolet e ta barazojmë garën, por edhe të ofrojmë qasje në financa që ju t'i rriteni e të forcoheni. Nuk e di se si i keni parë ndërtesar e zyrat e qeverisë e qeveritarëve deri dje, por sot ato janë në shërbim tuaj, prandaj mos hezitonit të na këshilloni e të na korrigoni sepse ne jemi aty që t'ju ndihmojmë juve”, ka dekluaruar Kurti. Ai ka theksuar se me Fondin Zhvillimor do të ofrojnë mbështetje për prodhuesit vendorë për ta shtuar cilësinë dhe kapacitetet, për ta rritur punësimin dhe për ta zgjeruar

tregun. “Mbështetje do të ketë për secilin sektor prodhues”, ka thënë ai. Kryeministri Kurti ka bërë me dije se qeveria do të investojë në sisteme të ujites së tokave dhe në sigurimin e çmimeve minimale për produkte bujqësore nga ana e shtetit. Ai ka folur për investimet e huaja në vendin tonë. “Investime të huaja në Kosovë ka pak sepse ka pasur shumë korruption dhe pak mbështetje. Korruzioni dhe mungesa e sundimit të ligjt, e shoqëruar me monopolet për kompani të caktuara, ka dëmtuar imazhin dhe ka frikësuar investitorët potencialë”, eshtë shprehur ai.

Në edicionin e dytë të Konventës së Prodhuvesve të Kosovës, kryeministri Kurti ka folur edhe për tarifën 100 për qind ndaj Serbisë. Ai ka bërë me dije do ta zëvendësojnë tarifën 100 për qind dhe do ta zbatojnë reciprocitetin e plotë tregtar me Serbinë sikurse me secilin shtet. “Tarifa ka qenë vendim i qeverisë së kaluar. Ne nuk jemi për tarifa si masë ndëshkuese ndaj konsumatorit, por për reciprocitet si masë mbrojtëse ndaj prodhuesve. Produktet që prodhohen në Kosovë e të cilat iu nënshtronen praktikave dhe konkurrencës jolojale do të mbrohen. Parimet e reciprocitetit që do të nxirren nga Qeveria e Kosovës do të janë të bazuara në parimet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe në CEFTA. Me mua sot eshtë ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, znj. Rozeta Hajdari, e cila ka bërë disa hapa të cilët na sjellin edhe më afér hedjes së tarifës dhe vendosjes së reciprocitetit të plotë. Rozeta tashmë ka marrë vendim për ta krijuar grupin punues me anëtarët nga Departamenti i Tregtisë, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda e Afaristëve të Kosovës, Dogana, AVUK-u dhe Klubi i Prodhuvesve të Kosovës. Ky grup do t'i përbledhë te gjitha barrierat tregtare me Serbinë dhe do të vijë me rekomandim te qeveria. Porsa të vijnë në zyrën time këto rekomandime do t'i analizojmë dhe do të marrim vendim për largim të tarifës dhe vendosje të reciprocitetit. Ne jemi shtet i



pavarur dhe sovran dhe do të veprojmë si të tillë”, ka thënë Kurti.

Duke folur për sigurinë e produkteve, ai ka thënë se mbrojtja e prodhuvesve vendorë sot shkon përfje punësimit dhe zhvillimit ekonomik dhe prek shëndetin e konsumatorit. Kurse Bashkim Osman, kryetar i Klubit të Prodhuvesve të Kosovës, ka thënë se e përkrahin tregtinë e lirë. “Prodhuesit e Kosovës janë shtresa më e rëndësishme dhe

vitale e vendit tonë dhe për zhvillim e vendit tonë. Ekonomia në përgjithësi dhe sektori i prodhimit duhet të janë prioritet i qeverisë tonë. Klubi i Prodhuvesve e përkrah tregtinë e lirë dhe besojmë që ky proces duhet të ndodhë. Për ne si prodhues, tregu i Shqipërisë dhe Maqedonisë eshtë prioritet. Kërkojmë nga qeveria e re që të na mbështetë, në mënyrë që sa më shumë të depërtojmë në këto tregje”, ka thënë ai, duke

shtuar se Kosova vitet e fundit çalon sa iu përket investimeve të huaja. Ndërkohë Astrit Panxha, drejtor ekzekutiv i Klubit të Prodhuvesve të Kosovës, ka thënë se problem është kualifikimi i punëtorëve. “Edukimi profesional duhet të jetë prioritet. Sot është problem kualifikimi i punëtorëve. Anëtarët e klubit janë përfaqësues të ekonomisë sonë dhe kërkojnë tregje të reja”, u shpreh Panxha.



Abdixhiku dhe përfaqësuesit e JICA-s diskutojnë për projektin për kontrollin e ndotjes së ajrit

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, të mërkurën ka pritur në takim përfaqësuesin kryesor për Kosovë të Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), Takeichi Jiro.

Në takim informues, Abdixhiku dhe Jiro diskutuan për projektet e përbashkëta, me theks të

veçantë për projektin për kontrollin e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës dhe për unifikimin e hartave topografike digitale.

Ministri Abdixhiku ka shprehur gatishmërinë për ta shtyrë përpëra realizimin e të gjitha projekteve që janë në proces në të dyja dikasteret që ai drejton dhe falënderoi JICA-n për ndihmën e vazdueshme në vendin tonë.

Mbahet debati publik për statutin e QKMF-së së Drenasit

DRENAS, 19 SHKURT (ER) - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Hafir Shala" dhe me komisionin për hartimin e Statutit të QKMF-së, të mërkurën kanë mbajtur debatin publik me qytetarë, ku është diskutuar dokumenti më i rëndësishëm për institucionet shëndetësore në Komunën e Drenasit.

Në këtë tubim me publikun kanë marrë pjesë drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies



Sociale, Arsim Haxhiu, drejtori i QKMF-së, Ismet Bogiqi, qytetarë të Komunës së Drenasit, punonjës të QKMF-së dhe komisioni për hartimin e statutit. Drejtori Haxhiu ka paraqitur para të pranishmëve këtë dokument, ndërsa qytetarët e pran-

ishëm kanë dhënë komentet e tyre lidhur me statutin e QKMF-së "Dr. Hafir Shala", dokument ky i cili pritet të diskutohet edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa dhe në mbledhjen e Kuvendit të Komunës për miratim.

Në Kamenicë pastrohet nga mbeturinat hapësira e dëmtuar nga qytetarët

KAMENICË, 19 SHKURT (ER) - Pas raportimeve nga qytetarët për hedhjen e mbeturinave mbrapa Shtëpisë së Kulturës, te rruga "Nënë Tereza" në Kamenicë, Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat (DShPAI) ka dalë menjëherë në terren. Zyrat e kësaj drejtorie



kanë bërë pastrimin e kësaj pjese nga mbeturinat e hedhura nga qytetarët, edhe pse po e njëjta

drejtori ka vendosur shenjat se ndalohet hedhja e mbeturinave në këto pjesë. "Pas pastrimit të saj, DShPAI dhe komuna u bënë lutje qytetarëve që të kenë kujdes në hapësirat publike, sepse një mosrespektim i tillë nënkupton gjoba", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.



Renovohet banesa e djegur e invalidit të luftës së UÇK-së

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se është rinovuar banesa e invalidit të luftës së UÇK-së, Metush Kamberi, e cila ishte djegur nga zjarri. "Banesa e Metush Kamerit, invalid i luftës së UÇK-së, ishte djegur e dëmtuar nga zjarri muaj më

parë. Ndërsa prej sot familja e tij tetanëtarëshe i kthehet banimit në banesën, tërësisht të rinovuar nga Komuna e Prishtinës. Jemi shumë të lumtur që gjetëm mundësinë për ta ndihmuar këtë familje", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.

Nis vaksinimi i kafshëve në Malishevë



MALISHEVË, 19 SHKURT (ER) - Si çdo vit, edhe sivjet Komuna e Malishevës në bashkëpunim me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës (AUV) janë duke bërë vaksinimin e kafshëve, ku përfshihen gjedhet, delet, dhitë dhe qentë. Vaksinimi po bëhet kundër sëmundjeve klostridiale, siç janë këmbëzeza, edema malinje, gangrena gazoze, dizenteria e qengjave, pastaj vaksinimi dhe dehelmetizimi i qenve shtëpiak. Vaksinimin e kafshëve të mërkurën e kanë parë nga afër nënkyetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha dhe drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Blektori, Murat Hoxha, të

cilët janë njoftuar me procesin e vaksinimit. Nënkyetari Berisha e ka vlerësuar si shumë të suksesshëm vaksinimin, si masë parandaluese ndaj sëmundjeve të ndryshme te kafshët, si dhe për mbrojtjen e popullatës nga sëmundjet që mund të transmetohen nga kafshët te njeriu përmes kontaktit dhe konsumimit të produkteve. Këtë vaksinim në territorin e Komunës së Malishevës është duke e mbështetur stacioni veterinar në Malishevë ndërsa sipas drejtorit të Bujqësisë, Murat Hoxha, procesi i vaksinimit është duke u kryer në mënyrë profesionale dhe po ecën mirë.

120 euro pako mbështetje për çdo fëmijë të porsalindur në Vushtrri

VUSHTRRI, 19 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka bërë me dije se kjo komunë do të ofrojë 120 euro pako mbështetje për çdo fëmijë të porsalindur. Ai ka thënë se në bazë të vlerësimeve, në Vushtrri çdo viti lindin rreth 600 fëmijë. "I kam propozuar Kuvendit të Komunës

që ta miratoj propozimpolitikën e re nga qeverisja komunale përmes së cilës do të mbështetet secili çift vushtrias me fëmijë të porsalindur e ku synohet të blihet një shtrat ose një pako me mjete të nevojshme për të porsalindurit. Sipas vlerësimeve tonë, kemi afër 600 lindje në vit në qytetin tonë,



30 vjet nga nisma e pajtimeve në Malishevë (16.02.1990)

FALJET ÇLIRIMTARE



Ragip SHALA

Thirrjes së LPK-së në janar 1990 për pajtme pa hezituar i janë përgjigjur veprimitarë klandestinë, të burgosurit politikë të cilët më 02.02.1990 ndërmorën iniciativën për Lëvizjen e pajtimit, përfaljen e gjaqeve, plagëve dhe ngatërrresave të ndryshme. Përveç me "Thirrje" nga Prishtina do të udhëtonim për Malishevë, Asllan Kastrati dhe Ragip Shala, që do të rezultojë me themelimin e Këshillit të Pajtimit më 16.02.1990, me përbërje: nxënës, studentë, profesorë, arsimtarë, punëtorë etj.

Fillimi i vitit 1990 shënon zanafillën e shpërbërjes së Jugosllavisë, një shpërbërje e përgjakshme shkaku i ambicieve hegemoniste serbomadhe të Serbisë në njëren anë dhe kundërvënia e Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjë Hercegovinës dhe Kosovës në anën tjetër.

Pavarësisht prej rrethanave të jashtëzakonshme, nën regjimin e pushtetit ushtarako-politicor, Kosova përmes demonstratave dhe grevave përbënte një zë të fuqishëm kundërvënieje të nacionalizmit dhe shovinizmit

serb. Përmasat e kundërvënieve buronin nga shtypja politike, ekonomike, arsimore, kulturore e popullit shqiptar në përgjithësi dhe Kosovës në veçanti. Përkundër posedimit të pasurive natyrore për zhvillim ekonomik, Kosova ishte vendi më i pazhvilluar, më i varfëri në RSFJ?! Papunësia e lartë në mungesë të kapaciteteve ekonomike, diskriminimi kombëtar ndaj shqiptarëve ka ndikuar që popullata të mbijetonte kryesisht nga bujqësia me mjete më primitive të punës. Përkundër rregullimit socio-politic socialist të R.S.F. Jugosllavisë, në Kosovë ka dominuar errësira feudaliste me tërë karakteristikat e saj, sidomos në raportet familjare të mbërthyera në tradita patriarchale, me zakone të prapambetura tipike të feudalizmit?! Tërë kontestet pronësoro-juridike dhe familjare janë rregulluar me norma të Kanunit të Lekë Dukagjinit që çuditërisht tolerohej nga regjimi socialist i Beogradit?!

Kjo "pavarësi" juridike, Kosovën e vari me "lak në fyt" gjatë tërë "vëllazërim-bashkimit" të kombeve dhe kombësive të RSFJ-së.

Rrethanat e tillë socio-ekonomike, të dominuara nga kanuni i Lekës, gjeneruan konflikte të ndryshme për çështje prone, çështje familjare, që rezulton me vrasje, plagosje dhe rrahje në mes të familjeve shqiptare.

Përgjatë viteve '70 dhe '80 disa

qindra familje kanë qenë të përfshira në hasmëri të ndërsjella me besë e pa besë, të ngujuara nga kodi i kanunit dhe frika e hakmarrjes. Në mungesë të masave preventive nga institucione të ndryshme, në fillim të viteve '90 Kosova rëndohej nga 2 000 hasmëri, shkaku i vrasjeve, plagosjeve dhe konflikteve të ndryshme?! 2 000 familje të ngujuara në njëren anë, dhe 2 000 familje në anën tjetër nën presion të drejtës për hakmarrje. Varfëria e skajshme ka ndikuar që familjet shqiptare të bashkëjetonin në një familje me shumë anëtarë. Nëse veçojmë mesataren prej 15 anëtarëve përfamilje të hasmuara, rezulton më se 60 000 pjesëtarë në hasmëri të ndërsjella?! Askush nga strukturat e pushtetit të atëhershëm nuk ka ndërmarrë kurrfarë masash parandaluese, zgjidhje të konflikteve dhe pajtim të atyre familjeve të hasmuara.

Pajtimi ka qenë kryesisht objektiv i disa "pleqve me zë" të cilët i kanë "pleqnuar" hasmëritë me norma kanunore dhe aty-këtu kanë arritur të pajtonin ndonjë familje, por jo dhe ta shuanin dukurinë e hasmërive. Inferioriteti i strukturave të pushtetit deri në instancat më të larta - Komiteti Krahinor i LKJ-së, përbën një bazë aktakuze karshi fenomenit të hasmërive në familjet shqiptare. Për çdo kritikë janë edhe intelektualë të ndryshëm: poetë, gazetarë, profesorë, arsimtarë si

dhe klerikë të dy feve që kanë qëndruar "duarkryq" dhe larg asaj dukurie të shëmtuar në Kosovë. Ngujimi i familjeve përfshakat e hasmërive ishte fenomen që shtrihet në tërë Kosovën. Edhe rajoni i Komunës së Malishevës nuk është kursyer aspak nga "pushteti" i Lekë Dukagjinit. Disa qindra familje kanë qenë të hasmuara dhe, si të tilla, të ngujuara në burg shtëpiak përvite të tëra. Në prag të shpërbërjes të Jugosllavisë në fillim të viteve '90, Kosova ishte nën rrëthim ushtarako-politicor, por që nuk dorëzohej përballë persekuimit të Beogradit. Gjatë tërë vitit 1989 është demonstruar fshat përfshat dhe qytet përfshat kundër okupimit serb, që rezultoi me disa dhjetëra të rinj të vrarë nga makineria vrastare serbe, dhe disa qindra të arrestuar dhe dënuar me burg.

Janari i 1990-s e zuri Kosovën të ngjujar në dy dimensione: ngujim nga "pushteti" i Lekë Dukagjinit dhe ngujim nga pushteti i shovinizmit dhe hegemonizmit serb? Kosova po vuante okupimin e dyfishtë sa nga vetvetja, sa nga hegemonizmi serb! Derisa struktura të LKJ-së në Kosovë akoma vazhdonin të besonin verbërisht në "vëllazërim-bashkimin" e kombeve dhe kombësive, Lëvizja Klandestine - LPK-ja qëndronë në ballë të kërkësës popullore për Kosovën Republikë.

Në janarin e acartë 1990 në çdo strukturë klandestine

parashtrohej pyetja: A mund të çlirohem i dëshironi që kanë qëndruar "duarkryq" dhe larg asaj dukurie të shëmtuar në Kosovë. Ngujimi i familjeve përfshakat e hasmërive ishte fenomen që shtrihet në tërë Kosovën. Edhe rajoni i Komunës së Malishevës nuk është kursyer aspak nga "pushteti" i Lekë Dukagjinit. Disa qindra familje kanë qenë të hasmuara dhe, si të tilla, të ngujuara në burg shtëpiak përvite të tëra. Në prag të shpërbërjes të Jugosllavisë në fillim të viteve '90, Kosova ishte nën rrëthim ushtarako-politicor, por që nuk dorëzohej përballë persekuimit të Beogradit. Gjatë tërë vitit 1989 është demonstruar fshat përfshat dhe qytet përfshat kundër okupimit serb, që rezultoi me disa dhjetëra të rinj të vrarë nga makineria vrastare serbe, dhe disa qindra të arrestuar dhe dënuar me burg.

Janari i 1990-s e zuri Kosovën të ngjujar në dy dimensione: ngujim nga "pushteti" i Lekë Dukagjinit dhe ngujim nga pushteti i shovinizmit dhe hegemonizmit serb? Kosova po vuante okupimin e dyfishtë sa nga vetvetja, sa nga hegemonizmi serb! Derisa struktura të LKJ-së në Kosovë akoma vazhdonin të besonin verbërisht në "vëllazërim-bashkimin" e kombeve dhe kombësive, Lëvizja Klandestine - LPK-ja qëndronë në ballë të kërkësës popullore për Kosovën Republikë.

Në janarin e acartë 1990 në çdo strukturë klandestine



Gara presidenciale e demokratëve zhvendoset në Nevada

UASHINGTON, 19 SHKURT - Gjashtë kandidatë demokratë ishin në Nevada për debatin e nëntë në kuadër të garës për të zgjedhur kandidatin zyrtar të partisë që do të përballet me presidentin Donald Trump në nënëtor. Senatori i Vermontit Bernie Sanders dhe ish-kryetari i bashkisë së South Bendit të shtetit të Indianës, Pete Buttigieg, vijnë në këtë debat pas paraqitjeve të fortë në Ajova dhe Nju Hampshér, dy shtetet e para ku u zhvilluan garat mes demokratëve. Senatorja e Minesotës Amy Klobuchar po kërkon të ruajë

rritjen e beftë që e renditi atë në vend të tretë në New Hampshér. Në mesin e kandidatëve për të cilët debatet dhe votimi i së shtunës janë një shans për t'u rikthyer te mbështetja që i bëri ata pretendentë të fortë në sondazhet e mëparshme kombëtare janë ish-nënpresidenti Joe Biden dhe senatorja e Masaçusetsit Elizabeth Warren. Në skenë për herë të parë do të jetë ish-kryetari i Bashkisë së Nju Jorkut Michael Bloomberg. Bloomberg ka shënuar një rritje në sondazhet kombëtare

në javët e fundit si dhe ka shpenzuar me qindra miliona dollarë përfundit e tij. Christian Lundberg, një profesor në Universitetin e Karolinës së Veriut tha për "Zërin e Amerikës" se ai mendon që Sanders do të përpinqet të pozicionohet si udhëheqës në zgjedhjet paraprake ndërsa Bideni dhe Warren do të përpinqen të minimizojnë humbjen. Në rastin e Bloombergut, ai thotë se pret një që ai ta shfaqë veten si kandidati më i mirë për të garuar përballë presidentit Donald Trump.



Pompeo në Arabinë Saudite, në fokus diskutimi për Iranin

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha se ne do të kalojmë shumë kohë duke folur për çështjet e sigurisë, në veçanti për kërcënimin nga Republika Islamike e Iranit dhe se ShBA-ja është e gatshme për të biseduar në çdo kohë me Iranin, por që regjimi iranian duhet ta ndryshoje rrënjesht sjelljen

UASHINGTON, 19 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, po qëndron përvizitë në Arabinë Saudite përbisedime me mbretin Salman dhe djalin e tij, Princin e Kurorës, Mohamed bin Salman si dhe ministrin e Jashtëm, Faisal bin Farhan, thanë zyrtarët e Departamentit të Shtetit. "Ne do të kalojmë shumë kohë duke folur për çështjet e sigurisë, në veçanti për kërcënimin nga Republika Islamike e Iranit", u tha Pompeo gazetarëve në kryeqytetin e Etiopisë para se të nisej për në Riad, njofton AFP, përcjell rfe.

Pompeo tha se Shtetet e Bashkuara ishin të gatshme përtë biseduar në çdo kohë me Iranin, por theksoi se regjimi iranian "duhet të ndryshoje rrënjesht sjelljen e tyre". "Fushata e presionit vazhdon. Nuk është vetëm një fushatë e

presionit ekonomik, por edhe e izolimit diplomatik", tha ai. Presidenti amerikan, Donald Trump, i cili mban lidhje të ngushta me Arabinë Saudite, në vitin 2018 u tërroq nga një marrëveshje bërtimore me Iranin dhe vendosi sanksione gjithëpërfshirëse që synojnë të zvogëlojnë ndikimin rajonal të Teheranit.

Vizita treditore e Pompeos në Arabinë Saudite, vjen pas një sulmi me telekomandë - të urdhëruar nga Uashingtoni - nga i cili u vra, Qasem Soleimani, gjenerali më i fuqishëm i Iranit.

Vrasja e gjeneralit, të cilin Shtetet e Bashkuara e konsideron si terrorist, ndodhi më 3 janar në Bagdad të Irakut. Tensionet rajonale u rritën, pas vrasjes së tij, pasi Irani u përgjigji me sulme raketash ndaj forcave



amerikane në Irak.

Zyrtarët amerikanë e kanë fajësan Iranin për një sulm në instalimet e naftës saudite, në muajin shtator të vitit 2019.

Arabia Saudite ka thënë se 18

dronë dhe shtatë raketa sulmuan dy rafineri të naftës në Abqaiq dhe Khurais më 14 shtator. Rebelët Huthi, që janë të lidhur me Iranin kanë marrë përgjegjësinë përkthënë sulm.

Qëllim kryesor i Iranit është të thellojë ndikimin dhe t'i mbrojë interesat e tij në Lindjen e Mesme, ose, së paku, t'i pengojë kundërshtarët, si Arabia Saudite, që të kenë më shumë pushtet.

Turqia dhe Rusia me kërcënime të ndërsjella për situatën në Siri

ANKARA, 19 SHKURT - Turqia dhe Rusia shkëmbjen paralajmërimë ndaj njëra-tjetrës lidhur me luftimet në Idlib të Sirisë. Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, kërcënoi se forcat turke do të ndërmarrin një operacion "të menjëherëshëm" në Siri për t'i dhënë fund sulmit brutal të regjimit sirian, ndaj bastionit të fundit që mbahet nën kontroll nga rebelët antiqeveritarë.

Erdogani tha se bisedimet me Moskën - gjatë dy javëve të fundit - nuk kishin arritur "rezultatin e dëshiruar" dhe parala-

jmëroi se Turqia do të niste një ofensivë në Siri nëse Damasku nuk tërhiqte forcat e tij deri në fund të muajit.

Kremlini iu përgjigj shpejt kërcënimit të Erdoganit, duke paralajmëruar se çdo operacion kundër forcave siriane do të ishte "skenari më i keq", raporton AFP.

Turqia mbështet rebelët që luftojnë kundër forcave të presidentit Bashar al-Assad, i cili gjëzon përkrahjen e Rusisë dhe Iranit.

Organizatat humanitare kanë bërë thirrje për një armëpushim

urgjent dhe një ndihmë ndërkombëtare, përgatit një milion njerëz, që po ikin nga sulmi i forcave qeveritare në provincën veriperëndimore të Idlibit.

Në fillim të kësaj javë, Kombet e Bashkuara thanë se të shpërndanin që foshnjat po vdisnin nga të ftohtit sepse kampet janë të mbipopulluara.

Sipas Vëzhguesit Sirian për të Drejtat e Njeriut, nga ofensiva e forcave qeveritare janë vrarë më shumë se 400 civilë që prej filimit të muajit dhjetor 2019. (rfe)



Urimi im për ty

Gëzuar kjo ditë e shenjtë për ne!

Elife PODVORICA

Eshtë ditë feste sot dhe qysh në mëngjes e bëra "agjendën" time. E nisa me një vizitë te Afrimi, i cili tani është afër shtëpisë sime, në varrezat e heronje të Kosovës. Që nga ardhja e tij këtu më duket sikur është ngritur edhe një flamur me sfondin e kuq në atë vend ku dalëngadalë po mblidhen yjet që i dhanë drithë kësaj toke.

Para se të afrohesha te vendi i heronje pashë turma të mëdha njerëzish që ishin nisur për t'i nderuar ata. Njerëzit vinin në grupe dhe me familje. Ata parakalonin në heshtje me respektin e madh në sy, ndalonin te secili dhe vendosnin lule të freskëta, ndërsa të rriturit u flisin fëmijëve, u tregonin për secilin nga ata emra që preheshin aty për këtë ditë që ne po e gëzojmë.

Edhe te varri i vëllait tënd po ashtu ndaleshin dhe tregohej historia e tij. E di që në zemrën time je sot këtu në festën e Kosovës, je këtu pranë varrit të vëllait tënd, andaj po mundohem ta bëj kujdesin e motrës edhe këtu, te fqinji im më i nderuar i kombit! Çdoherë kur jam tek Afrimi disi ndiej si shpaloset



veprimtar të lirisë.

- Oh hajde loçka jeme! Më përqafonte e më uronte mirëseardhje të ngrontë motra Mire me ëmbëlsinë e nënës!
- Urimë festa motra Mire! - i thashë në mes të përqafimit dhe gëzimit të saj.
- Nga dhoma e ndejës vinte zëri i një dokumentari televiziv mbi luftën e popullit shqiptar ndër shekuj, realizim i TVSh-së, të cilin kishte qenë duke e shikuar motra Mire.
- Vetëm je motra Mire?
- Po valla motra jem! Djali me punët e veta, vajza po ashtu!



fleta e lavdishme e historisë, si nis nënitori përflekshëm me emrin e tij dhe të Fahriut me shok!

Zërat e fëmijëve të shumtë që sot herë flisin e herë këndonin te varrezat e heronje të Kosovës, më ngjanin në cicërimë bilbilash që po i ledhatonin dhimbjet e nënave, baballarëve, fëmijëve të të rënëve. Kënga e gëzuar e fëmijëve po i ledhatonte plagët e Kosovës që kanë nisur të qetësohen nën gëzimin e Republikës.

Si gjethet e laurës që i vura mbi varre, që nuk vyshtken dimër e verë, ashtu mos u vyshkë kurrë kujtimi për ju! O djem e burra, heronj që me përpjekjet tuaja e çliruat këtë tokë, çliruat njerëzit e vendit tuaj, derdhët gjakun në lule të rinisë dhe tani po preheni në altarin e lirisë me madhështinë hyjnore! Lavdi!

U largova nëpërmes turmës dhe tani desha ta vizitoj motrën Mire, hallën që së bashku me bacën Ali e mbanin derën dhe zemrën gjithnjë të hapur për çdo student e

dhe i kujdeshëm njëkohësisht në çështjet kombëtare, por edhe për edukimin e fëmijëve të vet. Një ditë, teksha djali po rrëfente se donte t'i kryente edhe do punë të rendësishme e pastaj të merrej me përgatitjen e diplomës, pa një pa dy u ngrit dhe i tha: pa diplomë nuk i duhesh askujt, e as mua djalë pa diplomë nuk më duhet!

Nuk vonoi shumë dhe erdhi edhe ajo ditë kur djali duhej ta mbronte temën e diplomës dhe më mori edhe mua me vete.

I thashë po ç'të duhem djali im aty?! Unë jam një nënë e pashkollë dhe ata profesorët do të përqeshin ty!

- Kur shkuam në sallën ku mbahej diplomimi, djali ynë së pari na falënderoi ne dy prindërvë për kujdesin që kishim bërë gjatë studimeve të tij, pastaj profesorët e vet!

- O hallall të qoftë mundi im djali jem - thosha unë me vete! Sa shumë foli e foli dhe në fund të gjithë profesorët e lavdëruan shumë për punën që kishte bërë!

- Eh, djali jem! Vuajti shumë, ashtu si i ati! Kanë pas shtratin e njëjtë të burgut! Në shtratin ku ka fjet Aliu në burg, pas shumë viteve i ka ra hise djalit tim ai shtrat! - pshëreti motra Mire në një moment dhe shikimi iu hoq zvarrë kah dritaret e dhomës në të cilat po reflektorin



rrezet e diellit të kësaj dite me kuqe...

Motra Mire, kjo grua e ëmbël, që sa herë e takoi më duket se shfletoj faqe të reja të një historie, kapituj vuajtjesh, dhimbjesh, qëndrese dhe mbijetese. Gjurmë këto që kanë zënë vend në rrudhat e ballit të saj që padashje qesin në pah vitet e rënduara të një jetë furtunë... Më përcoll me dashurinë e një nëne. Ndërsa njerëzit në shesh e kudo nëpër lagjet e qytetit po festonin dhe po i gëzoheshin kësaj dite që ua kishte sjellë lirinë...

Teksa po ecja me hapin tim të rënduar nga pesha e emocioneve që kisha marrë këtë mesditë, mendoja sa shumë nëna e baballarë, motra e vëllezër, gra e fëmijë të të rënëve dëshmorë, në këtë ditë kanë një gërshtim të fortë dhimbjeje e gëzimi...



Por, dita ime nuk kishte përfunduar këtu.

Natyrrshëm u nisa për fshatin Llugë. Gjersa makina po merrte kthesën e drejtë nga bërryli që lë pas një mal me drunj të shpeshtë, përparrë m'u shfaq flamuri i madh kuq e zi, i cili sot po valëvitet hareshëm në qellin e kaltër plot diell. Afër tij dallova siluetën e një gruaje që ishte mbështetur në shkallët e obeliskut të Afrimit. E kush mund të ishte, veç nënës Qamë, e cila me një buqetë kajranfilësh të kuq po rrinte e thelluar në kujtimet e saj.

- Oh, nëna Qamë! Urimë kjo ditë! Urimë djalit tënd hero!

- U gëzofsh bija ime dhe qofsh e nderuar gjithmonë! Urimë djalit tim dhe të gjithë shokëve të tij! E gëzofshin këtë ditë fëmijët tanë e u irritshin të lirë e të gëzuar ashtu siç djali im deshi dhe bëri përpjekje deri në frymën e tij të fundit!

- Më besonte gjërat më të fshehta vetëm mua! Dija aq shumë plane e aktivitete të tijat që duhej t'i mbaja heshtur edhe pse shpirti im e dinte si! Por, sot që nga mëngjesi m'u ka kujtuar një ditë 8 marsi kur Afrimi i kishte kërkuar mësuesit të tij që ta lironë nga shkolla për të shkuar në

qytet dhe për të blerë lule për nënën e tij! Mësuesi, nga frika se ai nuk do të dinte të shkonte vetë në qytet, i mbledhë gjithë nxënësit e klasës dhe dalin në livadhin afër shkollës dhe i mbledhën ato lulet e para që dalin në pranverë. Qëllova në oborr dhe pasqë teksha po zbriste shpatit teposhtë me një tufë lule në dorë. Kishte të veshur një këmishë të bardhë dhe fytyra po i shkëlgente nga gëzimi kur më pa. Urimë nëna ime 8 Marsi - Dita e Nënës, më tha dhe më puthi në dy faqet! Hej zot! Si sot më kujtohen balluket që ia valëzonte era mbi faqet e skuqura nga vrapi që kishte bërë për të ardhur sa më shpejt te shtëpia - ... filloj rrëfimin e saj nëna Qamë, gjersa po i afroheshim shtëpisë ku na priste baca Osman me atë buzëqeshjen e tij e cila i shfaqet bujshëm sa herë që dikush

ia mësynë konakut të tij! Edhe në ditët më të vështira të jetës së tij, edhe në kohët më të trazuara, baca Osman ishte çdoherë i njëjtë në mikpritjen dhe bujarinë e tij llapjanë...

Urimë baca Osman Dita e Pavarësisë së Kosovës, - po e zgjasja unë zërin, duke u munduar të mbuloja ato nota dhembjeje që shiheshin në sytë e tij, me shikim të vagullt nga pesha e viteve që kishte mbërritur...

- Sot nuk munda të shkoja te varri i Afrimit - më tha me një ofshamë të thellë!

- Mos u mërzit baca Osman! Te varri i djalit tënd sot kishin shkuan përplot nëna e baballarë të rinj që po u flisin me krenarinë më të madhe fëmijëve të tyre, për birin tënd me shokët e tij!

Ai kështu deshi! Lirinë dhe kujdesin për kombin e njerëzit e tij... po fliste ai me sytë e drejtuar kah qilli i kaltër, ngjyrën e të cilit e kishte përthyer flamuri i lartë kuq e zi...

Gëzuar festa e dashur Sadete! U mundova të t'i sjell ca dromca jete nga Kosova jote! Nga Kosova e vëllait tënd - Afrimit!

Gëzuar!



Tentativë psikologjike për depërtim në mendimin e shoqërisë së sotme

Një vlerësim për dramën "Hamleti, njeriu i hijeve" e autorit Andrin Shyqeri Kabashi



Prof. Dr. Kudusi LAMA

Njerëzit lumturohen ose e ndiejnë lumturinë në mënyra të ndryshme. Unë e ndiej atë në sukseset e njerëzve. Në jetë shumë njerëz më kanë bërë të lumtur, por sot njeriu që më ka bërë shumë të lumtur është Andri, i cili, me gjithë moshën e tij, që nuk mund t'i themi akoma të re, por duhet thënë të vogël, shpalos një intelekt që lë mbresa. Andri është një djalosh që ka lindur më 17 tetor 2002, pra është vetëm 17-vjeçar dhe ka arritur të na japë deri tani botime mbresëlënëse. Dikush mund të thotë se ai është përkushtuar të lexojë dhe të shkruajë, por unë, duke e njohur nga afër, them jo. Ai është përkushtuar në gjithçka të mirë dhe të bukur në jetë. Andri është një nxënës që

merr vetëm notën më të lartë në shkollë, pra vetëm 5 (pesë) ose 10 (dhjetë) sipas nivelit të notave; që ka një sjellje model në familje, në rrugë, në shoqëri, në shkollë etj.; që nuk përton të marrë ngarkesë; që ruan në çdo situatë një qetësi prej diplomati, të cilët disa fenomene negative me të cilat ndeshet vetëm i bëjnë përshtypje thjeshtë - si kanë kohë njerëzit të merren edhe me gjëra të tillë; që lexon pa ndërprerje dhe zgjeron horizontin e tij. Njëkohësisht ambicia e tij shtrihet edhe në fushën shkencore, duke e zhvilluar kuriozitetin e tij në fushat e kimisë, fizikës, biologjisë, astronomisë etj. E në mes gjithë kësaj panorame të portretit të Andrit, spikat edhe letërsia, si lexues dhe si krijues, nëpërmjet së cilës ai është prezantuar publikisht me dramat e tij. Unë sot kam fatin që si redaktor i dramës së tij të

katërt ta bëj edhe prezantimin e saj.

Drama titullohet "Hamleti, njeriu i hijeve", që vjen me një dinamikë intensive, me freski dhe me një ndjenjë drithërimi me kthesat që merren në proces dhe me atë ndjenjën e pritjes që të dikton për të parë sa më parë atë që do të vijë. Duket sikur po zgjat kokën për të parë atë që nuk ka ardhur, pasi të krijohet ndjenja se është aty përtej perdes, por të akoma nuk është dukur.

Mund të ketë të tillë, që sa të shikojë në titull emrin Hamleti, titullin e dramës së Shekspirit, mund të mendojë se do të jetë një përsëritje e pa nevojshme. Dhe e them këtë sepse edhe unë kur e pashë, mendova se nuk ka gjë në të, pasi mendova se Andri thjeshtë ka bërë një përsëritje të Shekspirit. Por nuk është ashtu. Prej Shekspirit autorit ka marrë një Hamlet skandinav, që luan rolin e një të

çmenduri dhe ka krijuar një Hamlet shqiptar të kohës së sotme plotësisht të çmendur. Dhe është kjo dramë një pamje e shoqërisë së sotme shqiptare. Prandaj edhe Andri më duket se në mënyrën e tij, me fuqinë e talentit të tij, me përkushtimin e tij dhe me shqetësimin e tij, proteston ndaj kësaj shoqërie së pari shqiptare e edhe botërore të çmendur, duke u përpjekur të tregojë se çmenduria nuk të le rrugë tjetër veçse rrugën drejt varrit, dhe jo si njerëzit e zakonshëm, por i mbuluar me turpe, me kriminalitet, me përbuzje, me pabesi, me pasiguri, me vetmi, me shqetësim etj. Nëpërmjet veprës së tij autori na jep edhe mundësitet se si do të mund të mos jemi të tillë - të çmendur, për të bërë një jetë ndryshe, para se të vihem para ligjit si kriminelë a të përbuzemi nga shoqëria si të pa pranueshëm. Dhe këtë autori e bën me

shumë thjeshtësi, duke e konsideruar çdo veprim si të zakonshëm dhe të lehtë për të kapërcyer nga e keqja në të mirën, nga çmenduria në jetën normale.

Të shkruash dramë, do të thotë të veshë njerëzit në lëvizje, të krijosh skena të tilla, që t'i bësh njerëzit të ndjejnë emocione, të ndjejnë të nxehëtë e të ftohtë njëkohësisht.

Autori duke e ditur se konfliktet në dramë janë konflikte të zakonshme që ndodhin në jetën e përditshme njerëzore, e ka trajtuar me shumë thjeshtësi ngjarjen dhe e ka aktualizuar në mënyrë të tillë, sa që të duket se personazhet e dramës i shikon çdo ditë rrugëve dhe mjediseve tonë.

Por në rrugën e tij duket se Andrini ndjek idhujt e tij, si Shekspiri, Eskili, Sofokliu, Gëte etj.

Nëpër veprat e të cilëve rrugëton më së shumti, duke kërkuar të gjejë detaje që të ngrejë prej tyre kulme sipas mendimit të tij.

Që në fillim në shënimin e tij autorri na tregon se me çfarë do të përballemi, kur na shpjegon se: "Hamleti, njeriu i hijeve - eshtë një tekst dramatik, i cili në vete ngërthen çështjen e hakmarrjes, (mos)dashurisë dhe absurdit jetësor. Cilësimi i Albert Kamy-së se jeta eshtë një absurd, një poterë çmendije, përpunhet me jetën dhe stilin e saj hamletian.

Absurditeti i Hamletit dhe realitetit të tij, nuk ndalet në jetën e thjeshtë dhe modeste të shoqërisë sonë, por kalon barrierat e reales, dhe puthet me idenë metafizike të ekzistencës së njeriut dhe krijesave anormale në shoqërinë e tij. Sipas kësaj, del se Hamleti nuk eshtë një i çmendur, por ai thjeshtë jeton në çmendinë e jetës".

E me të drejtë lind pyetja: Sa të drejtë ka autorri që del në përfundim të tillë? Mendoj që ai i ka konceptuar dhe formësuar ngjarjet dhe personazhet duke arritur të hyjnë thellë në dramën e tyre, në botën e tyre psikologjike, duke qëndruar larg skematizmit, duke parë forcën e tyre te bota e brendshme shpirtërore, te idetë e mendimet që kërkon ndryshimi dhe zhvillimi shoqëror në kohën e sotme.

Në procesin e krijimit të dramës dhe të krijimit të personazheve e pasurimit të figurave të tyre, roli i fantazisë eshtë i domosdoshëm. Prej ku duket se Andrini ka talent, ka vullnet, ka përkushtim, për të arritur atë që dëshiron.

Nëse kjo dramë do të vihet në skenë, jam i sigurt, se shikuesit do të marrin shumë emocione, dhe do ta përfjetojnë plotësisht aksionin nëpër të cilin zhvillohen ngjarjet, duke i bërë pyetjet vetes: A jam unë pjesë e kësaj shoqërie? Ku e kam unë vendin tim në këto zhvillime? Çfarë roli eshtë ai në të cilin

eshtë uni im? Prej përgjigjeve të cilave krijohet panorama e vlerës së veprës.

Në dramën e Andrit do të gjeni elemente të tillë si ndjenja, paradoksi, e veçanta, kompleksja, e çuditshmjë, si dhe drita orientuese për të gjetur rrugën e daljes nga mjedisi i çmendurisë. Përzierja e kohëve eshtë një element që e shoqëron gjithë dramën dhe ajo që të krijon të çuditshmen, eshtë fakti se kohët janë përzierë me vetëdije, ashtu sikurse vendet ku zhvillohen ngjarjet, të cilat përfshijnë gjithë Evropën, sikur donë të na thotë, shikojen sa e vogël eshtë bërë bota, nëpër të cilën ecin edhe personazhet e dramës me pështjellimin e tyre psikik të kohës sonë.

Duke vlerësuar se Andrini ka dëshirën e mirë, të njohë e të zbatojë në krijimet e tij edhe parimet e letërsisë moderne, na e jep pamjen e ngjarjeve të veprës së tij nëpërmjet të papriturave të befasishme, krijimit të skenave në hapësira të mëdha mjedisore në kohë të kufizuar, konflikteve që krijon dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre, situatave dinamike etj.

Drama "Hamleti, njeriu i hijeve", vjen me ngjarjet e saj nëpër gjysmerrësirë. Dhe një zhvillim i tillë ka kuptimin e vet, pasi autorri mendoj se ka dashtë të na thotë, që megjithëse kemi sëmundje, megjithëse kemi çmenduri, shoqëria ka fuqi t'i shërojë këto sëmundje; ashtu sikurse na thotë se megjithëse kemi të çmendur e të sëmurë ata janë pak, që ndoshta mund të shkojnë edhe në vetëvrasje a në ndeshje e vrasje midis tyre, por një ditë do ta lënë të qetë e të pastër shoqërinë tonë, kuptohet edhe me punën e përpjekjet e vetë kësaj shoqërie, e cila ka vetinë e vetëshërimit.

Në këtë dramë duket sikur gjithë ngjarja zhvillohet në kokën e Hamletit, sikur eshtë një èndërr. Por që shpalosë gjithë problemet shoqërore, të pasigurisë, të mashtimit, të grabitjes, të përvetësimit të pasurisë së tjetrit, varfërisë shpirtërore, familjes së zvetënuar, shoqërisë së pabesë, njerëzve imoralë, kriminelëve, trafikantëve të drogës, shoqërisë së prostitucionit, njerëzve të shprishur moralisht, familjeve të shprishura; dukuri, përfundimi i të cilave na thotë autorri eshtë shkatërrimi i individit, sepse shoqëria e gjen rrugën të pastrohet prej tyre. Eshtë pikërisht ky mendoj mesazhi që na jep autorri nëpërmjet lojës së personazheve të tij, ku duket sikur thotë: - Pastrohuni, kthjellohuni, ndriçohuni, hiqni dorë prej veseve, prej krimeve, prej pabesive, prej urrejtjes dhe prej keqdashjes, bëhuni të mirë, në të kundërt gjithçka te ju do të jetë një hiq, ashtu si hijet e Hamletit.

Drama "Hamleti, njeriu i hijeve", eshtë një copëz jete e

paraqitur në 30 skena, të cilat vijnë shumë komplekse; duke filluar me një èndërr, vijon me një lojë në Hungari, zbret në një brengë në Prishtinë, në një tren e nëpër mjegull në çmenduri të plotë, del në Paris, vjen në Prishtinë, prapë në Paris, në aeroplani, përsëri në Paris, në Prishtinë, në Paris, në Prishtinë, në çmenduri, në Prishtinë, në varreza, në shtëpi, i përndjekur, i çmendur, èndërr, në dhomë të gjumit, prapë në varreza e në varrim, në dhomën e gjumit ku çmenduria merr krahë dhe pushton përfundimisht Hamletin të përballur edhe me tradhtinë ekstreme deri në dhomën e tij bashkëshortore, pasi eshtë përballur me hilet, mashtimet, krimet, shtyrjet, përndjekjet, vrasjet, arratisjet e presionet gjatë gjithë jetës. Dhe tani ka ardhur koha që Hamleti të vdesë, por të lërë trashëgim çmendurinë për të gjithë ata që kanë qenë në lidhje me të dhe të gjithë ata që e kanë ndihmuar të çmendet dhe të vdesë.

Prandaj edhe drama mbyllt në çmendinë, ku Hamleti i fton të gjithë drejt varrit, deri edhe nënën e tij.

Autori në mënyrë të quartë ka krijuar një rrëmujë shumë të larmishme, që jep pamjen e një laramanie e cila të bën të ndjesh të ftohtë, të dyshosh, të shohësh para e mbrota për t'u bindur nëse je vetëm dhe i sigurt në rrugën nga po shkon.


Por njëkohësisht drama të bën edhe të kesh guxim, të krijon bindjen se nëse nuk do të bësh vepra të këqija nuk do të pësosh asnjë të keqe, nëse nuk do të bësh krim nuk do të kesh as ndëshkim, nëse do të bësh të mira do të kesh gjithçka të mirë dhe me vlerë për vete, nëse do të jesh human do të përfitosh gjithë dashuritë e botës. Andrini me këtë vepër na tregon se ai di edhe të ndëshkojë edhe të lumturojë, por askënd me të padrejtë. Kështu në një mënyrë na krijon situata të tilla, që të dimë të orientohemi në jetë. Dhe këtë e bën një i ri, që akoma eshtë në fazën e adoleshencës, por me mesazhet e një të burri të mençur. Dhe të gjitha këto në një subjekt të ngërthyer në mënyrë të tillë, që edhe sikur ta lexosh nga fundi në krye, do të duket një vepër shumë e gjetur. Ndërkohë, tërheq vëmendjen një moment, ku megjithëse në dramë, megjithëse hero i dramës së tij, ai na flet thjesht, quartë dhe shqip, si Andrin, si djali me bindje kombëtare.

Kjo duket kur në monologun e Hamletit ai vë këtë pjesë: "... Kaluam luftë të përgjakshme, por tani liria eshtë e jona! E popullit tonë! E njerëzve tanë! O popull... o popull ju flas si bijve të mi. Duajeni tokën se për të gjak u derdh në lumenjtë e botës. Në frontet e luftës shumë nga të afërmëtanë vdiqën për tokën të cilën ju po e shkelni, e

në të cilën po jetoni sot në paqe! O popull, bëhuni syhapur! Hapni sytë dhe kënaquni nga mrekullitë e mbretërisë sonë! Kushdo që thotë se Parajsa eshtë ndryshe, e ka gabim! ... O popull ju them se sa të jem unë gjallë, asnjë armik nuk do guxoj të cenotë sovranitetin e mbretërisë sonë! Nuk do guxojnë as të na shohin me sy e le de më të na prekin! ... Do përleshemi me ta, ditë e natë, derisa ata të binden se kush jemi ne! Pra o popull, po ju them, se me mbretërimin tim, ju do të jeni të sigurt, ... O popull, ju ende nuk e dini se kush jemi ne! Ne jemi ushtri elitare! ... Dhe ju them o popull im, se heronjtë e popullit tonë... nuk kanë vdekur! Po, po! Ata jetojnë me ne këtu, në mbretërinë tonë, prandaj o popull, edhe nëse vdisni për atdhe, ju do jetoni në tokën tuaj, mbi gjakun tuaj, mbi bukën tuaj...".

Ky eshtë Andrini, por edhe autor i dramës "Hamleti, njeriu i hijeve". Unë jam i sigurt se e ardhmja për të eshtë shumë premtuese. Ai do të sjellë vepra të shumta në duart e shqiptarëve dhe më vonë shpresoj edhe të kombeve të tjera. Ashtu sikurse do të sjellë potencialin e tij të madh shkencor.

I uroj Andrit do të lumtur, të jetë me prindërit me motrën dhe vëllanë me shëndet të plotë e jetë të gjatë! Sukses!



“GJON MILI – njeriu kurth...”

Nga Besim FUSHA

...Mili nuk ju vret. Por, më zi se aq, ju zë të gjallë... Mili ju kap gjallë në gjendje të pagatuar... dhe ju përpëliteni në fotografinë e tij si peshku në rrjetë... Mili është njeriu kurth... – ka ca marifete... të ve në provë... simbas tij ka po aq mënyra për të dalë në fotografi, sa çka edhe njerëz... – tha Zhan Pol Sartri.

Gjon Mili – shqiptaro-amerikani, që, me artin e tij, ndjesoi Botën. Fotograf “Shqiptari gjenial” – e quante dramaturgu irlandez Sean O’Casey. Dhe thënia niste Botën, duke e braktisur autorin. Mbëse sepsë, diçka përtej autorit, i adresohej vërtetë gjeniut që “kurthoi...” gjenitë: Picasso, Matis, Sofia Loren... Sekondçaste domethënëse nga jeta e tyre. Përjetësimi. Dhe, madhështie figurative...


Prof. Dr. Safete Musa Juka (1921-2005) – (shqiptaria me vlera akademike në filozofji, art dhe letërsi franceze – lektore në Universitetet me vlera – Profesoreshë në Harvard... – universitet që ka “prodhuan” 8 presidentë amerikanë dhe 40 fitues të çmimit “Nobel”. Ismail Kadare, e ka cilësuar si intelektualen më të madhe shqiptare...) – i shkruan një miku dhe kolegu, Lec Shllaku, mbas vdekjes së Gjon Milit: ...Gjon Mili, mbas nji udhëtimi në Rumani, pat botue, në LIFE Magazine, një artikull në lidhje me familjen e vet. N’at artikull flit’te gjatë për nanën e ma shkurt për të jatin. Thonte kjashtas se e ama ishte shqiptare, përsa i përket babës, nuk u kuptonte krejtë mirë prej tekstit në se edhe aj, si e ama, ishte shqiptar. Përfitova prej rastit, kur i shkrueva për ekspositën... për me e pyet për kët gjë. Gjon Mili mu përgjegj pa vonesë tuej më thanë se nuk do të kishte dëshëruar që ndokush të kishte dyshim për origjinën shqiptare të babës së tij. Aj shtonte se, në fakt, si prindët e tij, ashtu edhe aj vetë, kishin lindë në Korçë.

Kur hapi një ekspositi në Paris (1946), prezantuesi e quajti Xhon... Gjon Mili – korigjoi... – tha se diku në këtë Europë ndodhet edhe në Shqipëri... dhe shqipja e ka një Gj. – që më piknis emrin... Heshtje. Që përshpejtoi ta përzente Zhan-Pol Sartri: "... kjo që thotë Gjoni do duartrokitur!" Dhe, nisi i pari. Nisi edhe fjalën e famëshme që Gjon Mili e mbante brenda vehtës si një hajmali... Zhan-Pol

Sartri i madh, tha:

Mili ka një kokë milingonangrenësi, një hundë që shkon t’i marrë erë botës shumë përpëratij, a thua se do ta zhysë papritmas në ndonjë fole milingonash, e pastaj, nën këtë hundë, shumë më prapa, ca mustaqe të vogla. Nga pjesa tjetër e fytyrës, sy, mollëza, flokë katrahurë, ai do të ngjante më fort me një cub malazez. Gjithsesi, është gjuetar dhe mishngrënës. Nuk kisha njohur, para tij, veçse fotografë me gjak të shterpët, që fotografon nga inati, ashtu siç vritet. Mili nuk ka inat; atij i pëlqen gjithçka: të hajë, të pijë, të kércejë; e njeh Harlemin më mirë se asnjë i bardhë, Nju Jorkun më mirë se askush. Ai është i lumtur. Nuk ka dëshirë t’ju vrasë. Puna është më zi se aq, do t’ju zërë të gjallë. Në portretet tuaja më të mira, ju jeni të vdekur të balsamosur, të kripur në hipsulfit, ashtu siç ju shndërron në brendësi më në fund përjetësia. Mili ju kap gjallë në gjendje të pagatuar dhe ju vazhdoni të përpëliteni në fotografinë e tij, si peshku në rrjetë, si puna e atij zhonglerit me cilindrë të mëndafshët që vazhdon të bëjë trishtueshmë në atë pamje numrin e tij dhe topat e të cilit herë dalin nga lëvizja përgjysmë si prej një bataku, herë përlloçen në të, herë shkrihen krejt me të, apo si ato kërcimtaret zezake që ai i ka futur në një kafaz e që hidhen më kot në tavan në përpjekje për të dalë andej, apo si ajo gruaja lakuriqe që ngjan si e parë me sytë shumëplanësh të mizave. Ai është një njeri-kurth dhe, për t’ju bërë të shkujdesur, ka ca marifete prestidigitatori; ai nuk kënaqet që t’i kapë njerëzit e famshëm me aparatin e tij, por bën hall që çdo fotografi të jetë një vënie në provë: sipas tij, ka po aq mënyra për të dalë në fotografi sa ç’ka edhe njerëz. Po të bini brenda, jo vetëm që do t’ju ketë ngulur për së gjalli me gjilpëra me kokë në koleksionin e tij, por edhe do t’ju ketë vëzhguar, do t’ju ketë njohur: do t’i jeni dorëzuar dyfish. Popujt primitivë të Deteve të Jugut, siç tregohet, nuk lënë njeri që t’i fotografojë; u duket se po i robërojnë dhe se po ua rrëmbejnë timonin nga duart për jetë të jetëve. Shiheni fotografinë e Molotovit nga Mili dhe do ta kuptioni mençurinë e tyre.

Ka qenë messhkurti i vitit ‘84, kur mbarë Bota njoftonte vdekjen e Gjon Milit. (Bazuar në të shpejtën “The New York Times”). Shqiptarët këtu, të shurdhër e të heshtur... (Radiovalët që mund të çanin pengesat dëgjoheshin “hajdutshe”... e, po “hajdutshe”, ende zorshëm përshpëritej veshëve). Në të vërtetë lajmi e kapërceu praghyrjen e ATSH-së,



Gj. Mili dhe macja e tij Blackie, New York, 1946

por «Axhanset e verdha», ashtu të blinduara, rreptësish adreso-heshin vetëm për “Bllokun”. Unë e vola fletën lajmëse për Milin – por, kush më ndihmoi, kërkoi ngulshëm t’i kthehej se, “ashtu ishte puna...” Qenë ditët e një tensioni të jashtnatyrshëm, qetësiprishëse, të pandodhura në ASHSH, duhej arritur FESH (Fjalori Enciklopedik Shqiptar), thuhej pragveshëve se “xhaxhi” (E.H) që sëmurë dhe “t’ia bëjmë qefin në datëlindje...” (Madje shtohej me marifet se, kush pëngonte mbante përgjegjësi penale). Ç’do tetë të mëngjesit mblidheshim për detyrat, në ca zyra kote, ashtu frymëngirë, në godinën e akullt antike të Toptanasve. A.Papa guxoi për Nënë Terezën... Të shtohej ndër

figurat. Dhe foli për të. Qe hera e parë që dëgjova se një shqiptare pat “habitus” Indi, zhuri Nobeli (1979) dhe njerëzimin mbarë... Unë mora vrull dhe propozova Gjon Milin. “Ç’është ky?” - u pyet. Ç’ka bërë? “Ku ka punuar? A e ka dashur Shqipërinë?...” Ç'bënte gjatë Luftës!... -Atë që bënин tërë amerikanët. Megjithatë, Mili jonë, fotografë të varfërit nën Statujën e Lirisë... Për revistën “Life”... -Qe thënia më kote që kam folur ndonjëherë. Sigurisht nga e papritura kësijo dhe përpjekja për ta “shpëtar”... Një tis bezdie nisi ta shtynte entuziazmin drejt portës së inattit... Por, s’u zgjat. -Ama në “Life” ka punuar?

Mbylle atë muhabet...edhe për Terezën... Borxh s’u kemi. Në shtypin tonë asgjë s’është shkruar ndonjëherë dhe, ne vjelim arritjet e shkencës shqiptare... “Greku” A.H. me luajti syrin. Unë heshta. Dhe u myll. Dy shqiptarët e mëdhenj, Nënë Tereza dhe Gjon Mili, mbetën jashtë faqeve të FESH. Mbetën jashtë edhe plot të tjerë... Me më kryesorin Mehmet Shehu, kryeministrin më detyrëgjatë në këtë truall, që qe vrarë apo vetrarë, nja një vit e ca më parë. Përkundër nisën të shtoheshin të tjerë gjatë botimit – me prapaktheu plot telashe të zorshme... – figura hiç... që, së pari po i dëgjoja: V. Çerava, Mine Guri, Petro Dode dhe... – ç’ta zgjasim, ngase është ngjarja më

cingërrimë në tërë historinë rreptësisht të papërshkrueshme të mendësisë a situatës që ndërtoi së pari Monumentin e Kulturës Shqiptare: FESH-in (1985). Thellësisht në kohë do të mbetet aq më shumë Monument, tamam sepse, mbart mbi kurriz ç'ka duhej e s'duhej, mangësinë a plotësinë e tamam kësaj: ç'ka duhet e s'duhet... si në refleksionin e një pasqyre të rreptë. Qenë kohë tryrsnie "robotike" aqisoj, për produktin e së cilës, shqiptarët e punës këtu (të ndërgjegjësuar ose jo), me shumë se me faj... kanë veçse meritë...

Një nga fotografët më të mëdhenj të shekullit, Gjon Mili, ndërroi jetë në Stamford, në Connectidut, më 14 Shkurt 1984. Shërbesa fetare dhe homazhet u kryen në New York më 16 shkurt, aty ku Mili kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij.

Ai i pati kryer studimet në Institutin Teknologjik të Massachusetts, MIT. Ku edhe u diplomua si inxhinier elektrik më 1927.

Menjëherë më pas u ngarkua nga Westinghouse për të bërë kërkime mbi dritën në laboratorët e tyre. Aty punoi një 10 vjet.


Debutimin në karrierën si fotograf e pati më 1937, kur ai filloi të përdorte shkencërisht flashin elektronik, për të shprehur lëvizjen. Shkurt: ndriçimin e fragmentuar të lëvizjes në sfondin e terrshëm... – shpikur nga miku i tij Harold Edgerton. Gjon Mili u bë shpejt i njohur dhe u vlerësua me të gjitha meritat në SHBA, ku ai punonte dhe jetonte. Mili, bashkë me familjen, iku pesë vjeç në Rumani. Mori aty shkollimet e mesme. Iku 9 vjeç në Amerikë, mbaroi shkollimet e larta dhe u punësua atje. Fill mbas Luftës së viteve dyzet (1946), Mili kërkoi të vinte në Shqipërinë e dashur por, edhe herë të tjera, prap nuk u lejua. Arsyja "e heshtur" le të themi se qe – ngase punonte në shtypin Amerikan...

Gjon Mili lindi më 1904 (28

Nëntor) në Korçën shqiptare, kujtimeve për të cilën, i qëndroi besnik.

"Fotografia", thoshte Mili, "jo domosdoshmërisht duhet të të ftojë të reflektosh, por duhet të shokojë spektatorin dhe ta "ndërsejë" të perceptojë anomalinë e arratisjes"...

E thëna e Heraklitit: "gjithçka është dhe s'është, gjithçka është fluide, paperë në ndryshim, ç'do gjë ekziston dhe zhduket vazhdimit..." hyri thellë brendësisë së Milit, qysh herët, në vitet mbasuniversitare. Atëherë kur Mili e pat gjetur rrugëzimin e jetës: Fotografia. Mbaroi në Massachusetts Institute of Technology, për elektrike, më 1927. Dhe për dhjetë vjet (deri më 1937), që inxhinier ndriçimi në Westinghouse Corporation në Cambridge. Punoi tamam në konstruimin e fijeve të llampave për projektin. U arri sinkronizimi i fotografimit deri në 1/250 e sekondës me flash-lampat e ndërtuara nga fije aluminji (zbuluar në Gjermani më 1931). Por Mili kërkonte më shumë. Ekzistencë dhe zhdukja i ndodhin kësaj jete pambarimisht në thërmijë. Si mund të "ndalet" një predhë topi, pushke...? Si mund të copëzohej e "vilej" lëvizja e padukshme e një objekti? Dhe shansi erdhë. Bashkëpunimi me Harold Edgerton. Që mundësuan 1/100.000 e sekondës. Lindi kështu fotografimi artificial i ashtuquajtur stroboscopic. Që lypte tashmë vetëm imagjinatë. Meritën për të cilën e plotpushton Mili. Me valltaren e "copëzuar" deri në "pakuptim". Me predhën e "ngrirë" në grykë të topit. Me... 1937: balerina e shkathët B.Fridman u fut në kurthin e eksponimit të shumëfishtë. «Life» e Nju-Jorkut ndërroi pamjen. Habitë lexonjësit. I mbërtheu në kureshtje: mendim të thellë dhe tisin e humortë që rezonte emocioni i copëzimit të lëvizjes a energjisë njerëzore



brenda një kuadrati. Kjo "përkundje" në hapësirë, kjo ngulje njëkohësisht e pjesëzës së lëvizjes, theu plotësisht ligjet e kohës dhe gravitacionit. "Life" shtoi famën dhe të famshëm e bëri edhe Milin. Që nisi udhët e Botës. Në vende, popujt, njerëz... Të thjeshtë e të njohur. Artistë, politikanë, shkencëtarë. Në ngjarje të mëdha të Botës: në qendra kulturore, sporti, politike, arti. "Shqiptari gjenial",

shkeli Botën, e fiksoi atë me mund dhe mend dhe zuri vend edhe në të gjitha librat shkollore të edukatës artistike si mjeshtri i "çastit të llogaritur". Veçse jo në librat shqiptare. Aspak për arsyen e thjeshtë dhe të qëndrueshme: që edhe s'pati arsyen.

Kur vërejmë se një kuadrat fotografik mbart brenda vetes sharmin që të përnxit... ndër të tjera themi edhe: "ky fotograf paska sy..." Dhe, meqë punët fotografike që vërtetë përnxisin, e thëna "paska sy..." adresuar Gjon Milit, duket e mangut... Përse? Ngase, parësore në imazhet e Milit, mbetet ngulitëse vlera e "syrit të shpirtit..." Që është një shkallëzim majëlart, tutje nga "syri vëzhgues..."

Harold Edgerton e shpiku përpjestimin nënsekondësh të komandimit të dritisë, – e ashtuquajtur stroboscopice... Gjon Mili e aplikoi... E përjetësoi dashurueshëm. Shpikësi mbeti më mbrapa... Pikëvështrimi mbetet përherë relativë vlerësuese. E bën domethënëse një vepër arti. Ka rëndësinë e vet "syu vëzhgues". E thotë me të drejtë Sartri, se Mili është "njeriu kurth"... Diçka që mund të thuhet edhe për nënsekondin e lëvizjes. Të rrökësh gjetshëm shprehinë e lëvizjes përballë, mbetet kapje "breshëri" edhe e "syrit vëzhgues"... Por, një vepër arti në fotografi, lyp edhe

të tjera ndjesi... – komplekse – sukseseve... – për ta cilësuar autorin në shkallëzimet e artistit dhe personalitetit... Gjon Mili ka "grackë" edhe "syrin e shpirtit..." "Syri i shpirtit" i artistit fotograf plot-zotëron "Grepin grackë..." "Syri i shpirtit" vështron tensionueshëm plot-hapësirën e imazhit... me gishtin në shinjestër godet çastin më të ngopshëm. Ndjerë së brendshmi, mundi finalizon arriten. Në grimcëkohën që kërkohet me nge, imazhi bie në grackë mëvetishëm. Ka një "thirrje" të çlirisë së objektit, ka një goditje aspak trembëse, ka një puqie që e rrok pamjen plot jetësi... Mbëtët një ndalje fryme si dëshmi... ai gllabërim i imazhit – një mëvete zotërimi ai nënsekondësh i goditjes... Mbëtët vepra që ndjeson art... Grimcëkoha fiksohet, ndalet ç'kapet... më nuk ikën – mbetet monument... lind kështu, imazhi i ndjeshëm, i ngopur me art... "Grepin grackë" ka plot-zotëruar dhe përjetuar hapësirën artistike... – e ka siguruar pavdekshëm me kyçin e artë... "Syri i shpirtit" së fundmi "rehatohet"... vëzhgona e pret në heshtje për të mbledhur opinion... Pra, kështu, imazhi i ndjejës, natyrshëm "krekojet" përballë gjykimit të ardhmës...

A ka imazh nga ç'na la Gjon Mili, që të mos krenohet përparrë syve tanë?! /Exlibris.al



E rrallë

Breshka fluturuese bie në rrjetat e peshkatarëve vlonjatë

Një tjetër specie e rrallë ka rënë në rrjetat e peshkatarëve të Vlorës. Breshka fluturuese, siç njihet në gjuhën shqipe, është një specie e cila në brigjet vlonjate është rastisur thuajse pesë herë në gjithë historinë. Kjo tregon për veçantinë e saj dhe mosfrequentimin e shpeshtë të brigjeve vlonjate. Breshka mbi shpinë ka pasur parazitë të detit të cilët e bëjnë ta hum-



basë drejtimin dhe të dalë në ujërat tonë dhe më pas në cekëtinë. Peshkatarët e Vlorës ia kanë pastruar parazitët për ta hedhur sërisht në det.

FOTO E DITES



Mjegulla mbulon bazën e Kullave të Kuvajtit në kryeqytetin e Kuvajtit. /AFP/

E jashtëzakonshme

Tmerrohen qytetarët, jastëkë të mbushur me gjarpërinj hidhen në rrugë

Qytetarët në Britani janë shokuar kohët e fundit, pasi në rrugët e Sunderlandit janë hedhur jastëkë të mbushur me gjarpërinj. Së fundi në qytetin e Sunderland u gjetën 15 gjarpërinj të futur në një thes dhe të hedhur në rrugë. Kjo është hera e dytë



që ndodh një fenomen i tillë, pasi një javë më parë u gjetën 13 gjarpërinj të futur në një jastëk dhe të hedhur në rrugë. Gjarpërinjtë u morën nga grupet e posaçme, ndërsa rezultoi se gjendja e tyre ishte e mirë.



DASHI
Për shkak të Hënës armiqësore, mos u besoni shumë ndjenjave tuaja: rrezikoni të mos shihni realitetin ashtu siç është.



DEMI
Yjet do ta nxisin vetëbesimin tuaj dhe ndjenjën e të pasurit shumë karta për të luajtur. Intuita, ndjeshmëria dhe shkathtësia janë në krye të ditës së sotme.



BINJAKËT
Çdo sekret dhe e fshehtë një ditë do të zbulohet që kështu më mirë është të jeni të drejtë përdrejtë dhe të singertë me të gjithë.



GAFORRJA
Do të korrni shumë sukses, nëse përdorni fjalëkalimet e duhura: angazhim, saktësi dhe reflektim!



LUANI
Mos prisni të shfaqen probleme shëndetësore që të filloni të kujdeseni për veten tuaj, kushtojini një vëmendje të madhe stilit të jetesës.



VIRGJËRESHA
Sot do të keni një dëshirë të madhe përgatit. Në shoqëri do të jeni të paparë dhe do të lëvizni me lehtësi edhe mes njerëzve që nuk kanë lidhje me mjedisin tuaj.



PESHORJA
Nëse përqendroni vëmendjen tuaj në praktikë, nxiton, problemi do të zgjedh! Nëse nuk keni shijuar një marrëdhënie të kënaqshme me partnerin tuaj kohët e fundit.



AKREPI
Sot do të jeni të mbushur me dashamirësi dhe me emocione pozitive. Në fakt, fati ju buzëqesh dhe ju ndihmon me disa projekte të zgjaura.



SHIGJETARI
Është koha e duhur për një takim të veçantë me një person që do ta kapërcejë selektivitetin tuaj rigoroz. Do të lidhni marrëveshje shumë fitimprurëse.



BRICJAPI
Mund të thuash! Do të përjetoni emocione të forta në frontin sentimental. Një diskutim me partnerin duket i pashmangshëm.



UJORI
Ndjenjat tuaj janë përforçuar sot, do të keni plot biseda me njerëz të rendësishëm dë të qeshura pafund. Duke shmangur problemet dhe situatat e pakëndshme, ju mbroni paqen tuaj të mendjes!



PESHQIT
Do t'ju ofrohen mundësi në fushën profesionale që ju do të duhet të shfrytëzoni, duke injoruar atraksione të tjera që do t'ju bënë ta humbni kohën.

BARSOLETA E DITËS



- Kamerier, ndërroma këtë ushqim!
- Pse?
- Se ka dhjetë minuta që i bëra foto dhe e publikova në "Facebook" e askush nuk ia ka bërë 'like'.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00
Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00
Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00

STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30

THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea DuVall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

Victoria Pendleton, mahnitëse në fustan të zi




© Getty Images for Laureus

Ajo është një ish-çikliste olimpike, karrierën e së cilës mund ta shihni të zbuluar me medalje. Por Victoria Pendleton tregoi praninë derisa eci në tapetin e kuq së bashku me Liam Payne në ceremoninë e


ndarjes së çmimeve të Sporteve Botërore 2020 Laureus në Berlin. Ylli i sportit, 39-vjeçare, ishte për të parë këtë ngjarje, duke dhuruar një fustan të zi pa mëngë me dantellë, detaje të qëndisura përgjatë vijës së qafës.

Bella Hadidi si e motra, pjesë e ballinës “LOVE”



Bella Hadidi tashmë është pjesë e listës së supermodëve më të kërkuar në botë. Por ajo i është bashkuar së fundi motrës së vet më të madhe, Gigit, ndërsa është bërë pjesë e ballinës së revistës së njojur “LOVE”. 23-vjeçarja u pa duke

festuar suksesin të hënën ndërsa firmosi kopjet dhe përqafoi miqtë e saj model në Dover Street Market gjatë Javës së Modës në Londër. Më parë Bella ishte e para dhe qendra e vëmendjes për koleksionin e “Burberryt”.



Dua Lipa nis xhirimet e videoklipit të ri

Këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare, Dua Lipa, shpejt do ta sjellë projektin e ri muzikor. Dua ka nisur xhirimet e videoklipit të saj më të ri. Në mediat e huaja po qarkullojnë disa fotografi ku artistja

shqiptare shihet duke tymosur duhan derisa po pushon nga xhirimet në Nju Jork. Dua në nëntor të vitit të kaluar ka sjellë projektin “Don’t Start Now” që tani ka plot 140 milionë shikime në “Youtube”.

Amber Rose thotë se vdekja e Kobe Bryantit e inspiroi për tatuazhin në ballë



Amber Rose ka shkaktuar shumë reagime kur javën e kaluar është parë me një tatuazh të madh në fytërë. Modeluesja 36-vjeçare që ka bërë tatuazh në ballë emrat e dy djemve të saj, Slash dhe Bash, e ka shpjeguar se pse e ka bërë një gjë të tillë. “Nuk dua që kjo të tingëllojë

keq, por vdekja e Kobe Bryantit më bëri që të reflektoj për jetën time. Nuk dua që njerëzit të mendojnë dhe të thonë: ‘Oh, Kobe vdiq dhe ti shkove dhe bëre një tatuazh’, por ishte pak a shumë kështu”, ka thënë ajo në “One on One With Keyshia Cole” - një nga seritë e “Fox Soul”.

Kosova e motivuar, kërkon fitore sonde ndaj Islandës

Kosova me trajnerin e ri Christos Marmarinos është e motivuar maksimalisht për të shënuar fitore sonde (e enjte) ndaj Islandës në kuadër të parakualifikimeve për Botërorin 2023. Ndesha zhvillohet në Prishtinë nga ora 19:00



**EPOKA
ERE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll të mërkurën e ka zhvilluar stërvitjen e fundit për ndeshjen parakualifikuese për Botërorin 2023 kundër Islandës, e cila zhvillohet sonde (e enjte) nga ora 19:00 në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. "Dardanët" janë të motivuar për sukseset në ndeshjen ndaj islandezëve, e cila ka rëndësi të madhe për të dy skuadrat përfaqësuese. Drejtori i Përfaqësueses së Kosovës, Granit Rugova, ka konfirmuar se basketbollistët janë të motivuar dhe të përgatitur për këtë ndeshje. "Basketbollistët janë shumë të motivuar për ndeshjen ndaj Islandës. Kemi pasur tri ditë

intensive me stërvitje dhe jemi të gatshëm për ndeshjen e së enjtes. Besoj se edhe me ndihmën e 'dardanëve' dhe tifozëve do t'a dalim në këtë takim përballë Islandës, që ka shumë lojtarë cilësorë, megjithatë lojtarët do ta jalin maksimumin në fushë", ka thënë Rugova, i cili më pas ka konfirmuar dy mungesa të rëndësishme në formacionin e Kosovës: Lis Shoshi dhe Alban Veseli.

Kosovë për herë të parë ndaj Islandës e drejton përzgjedhësi Christos Marmarinos, i cili pak ditë më parë më shumë entuziazëm e mori detyrën e re. "Basketbollistët kanë dhënë gjithçka në stërvitje dhe kjo është shumë e rëndësishme për ne. Është e rëndësishme që të gjithë ta jalin më të mirën nga vetja. Deri më tani jam shumë i

kënaqur. Duam të përfaqësojmë sa më mirë Kosovën në garat ndërkombëtare", ka deklaruar Marmarinos. Optimist është shfaqur edhe kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha. Basketbollisti që është rikthyer në skuadrën e Pejës ka kërkuar përkrahje nga tifozët përfaktin se është me lehtë të arrihet deri te suksesit. "Motivi është i madh në ekipin tonë dhe atmosfera shumë e mirë. Kemi pasur stërvitje intensive në këto tri ditë. Shpresoj se palestra do të jetë e mbushur me tifozë, sepse ky është një motiv për lojtarët në fushë. Ne duam të kemi rezultate sa më pozitive dhe me ndihmën e tifozëve mund t'ia dalim", ka thënë Berisha. Pas ndeshjes me Islandën, Kosova më 23 shkurt përballet me Luksemburgun.


Pas dy vjetësh rikthehet Jashanica

TIRANE, 19 SHKURT - Bajram Jashanica është një luftëtar dhe nuk di të dorëzohet. Jo pak, por dy vjet qëndroi jashtë futbollit për përdorimin e substancave të ndaluara, pasi mjeku i ekipit i kishte dhënë një medikament

pas një dëmtimi, që do të rezultonte i gabuar dhe fatal për mbrojtësin. Por dy vjet kanë kaluar tashmë dhe Bajram Jashanica mund të jetë gati me Skënderbeun që në ndeshjen e fundjavës, atë

kundër Teutës. Ajri i fushës ka nisur të ndihet sërisht, ndërsa Jashanica do ta shkelë barin përtë marrë sërisht oksigjenin e munguar. Sigurisht që nëse do të vazhdonte të luante në të njëjtën mënyrë me

Skënderbeun dhe nuk do të merrej ai medikament, Jashanica do të ishte me një skuadër tjetër evropiane, por këtë objektiv do të kërkojë ta arrrijë duke e rinisur atje ku e la, te Skënderbeu.



SHKURT

Kosovë - Rusi, më 6 mars në Wiesbaden

Përfaqësuesja e Kosovës (femrat) do të luajë më 6 mars kundër Kombëtares së Ruseve në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2021". Ndesha do të zhvillohet në stadiumin "BRITA-Arena" në Wiesbaden të Gjermanisë në orën 18:00, kurse hyrja do të jetë pa pagesë. "Dardanet" deri më tash kanë zhvilluar tri ndeshje kualifikuese në kuadër të Grupit A, duke realizuar dy fitore e një humbje. Kosova arriti të imposhtë në shtëpi Turqinë 2:0 dhe Estoninë si mysfire 2:1, kurse pësoi humbje nga Slovenia si mysfire, 0:5. Gjashtë pikë nga tri ndeshje të zhvilluara i ka arkëtuar edhe Rusia.

Rashica, synim i Liverpoolit

Sulmuesi i Kosovës, Milot Rashica, është synim i Liverpoolit. Lajmi i bujshëm publikohet nga gazeta prestigjioze gjermane "Bild". Sipas të përditshmes në fjalë, të kuqtë janë në kërkim të një alternative të vlefishme për të qenë zëvendësuesi i parë i treshes magjike të sulmit Salah-Mane-Firmino. Sulmuesi i përfaqësueses së Kosovës ka një klauzolë largimi prej 38 milionë eurosh nga Werder Bremen, shifër që Liverpooli është i gatshëm ta paguajë. Pjesë e Liverpoolit është edhe futbollisti tjetër shqiptar nga Kosova, Xherdan Shaqiri.

Shala kualifikohet në LO "Tokio 2020"

Mundësi nga Kosova, Egzon Shala, është kualifikuar në Lojërat Olimpike "Tokio 2020". Lajmi është kumtuar nga Federata e Mundjes së Kosovës në faqen zyrtare. Shala kishte përfunduar në vend të gjashtë në Botërorin e mbajtur në Kazakistan, ku gjashtë të parët u kualifikuan në "Tokio 2020". Por, pasi një nga gjashtë të parët është kapur me doping, Shala është ngritur në vend të gjashtë dhe është kualifikuar. Federata e Mundjes e Kosovës ka njoftuar se ka marrë konfirmimin nga Federata Botërore e Mundjes. Shala garon në kategorinë deri 125 kilogramë në stil të lirë.

Ferizaj transferon talentin Aurel Idrizi

Skuadra e Ferizajt që po lufton për mbijetesë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll e ka prezantuar të mërkurën Aurel Idrizin. "Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se klub i ynë ka arritur marrëveshje me talentin Aurel Idrizi. 19-vjeçari është transferuar nga skuadra gjermane FC Memmingen U19. Ai ka nënshkruar kontratë 3-vjeçare me klubin tonë", thuhet në njoftimin e Ferizajt. Idrizi luan në pozitën e sulmuesit, kurse më meritor i përfundon përfundimisht në këtë transferim është drejtori sportiv i klubit Ferizaj, Nadir Haxhimusa.


Becker: Federeri nuk është tenisti më i madh në histori

BERLIN, 19 SHKURT - Roger Federer është tenisti që ka qëndruar më shumë javë në krye të renditjes botërore, 310. Ai, gjithashtu, është tenisti që ka fituar më shumë grand slame se të tjerët. Megjithatë, për një tjetër ikonë të këtij

sporti, Boris Becker, këto janë vetëm shifra dhe Federer është tenisti më i madh i të gjitha kohëve. "Nëse flasim për shifra, jam dakord që Federer është tenisti më i suksesshëm. Gjithsesi, për mua ai nuk është tenisti më i madh në histori.

Me kalimin e viteve ky sport ka ndryshuar shumë. Mos harroni, ikonat e këtij sporti në vitet '70, '80 apo '90, ku është luajtur në sipërfaqe të tjera dhe ka pasur të tjerë tenistë të mirë", ka thënë Becker. Ish-tenisti gjerman vazhdon ta

mbështesë Novak Djokovicin si teniston më të madh të cilin e ka trajnuar disa vjet më parë. "Jam i sigurt se Novak do të jetë më i madhi. Ai ka ende edhe disa ditë përparrë për ta konfirmuar këtë gjë", ka dekluar Becker.



Unitedi synon që formët e mirë ta bartë në Ligën e Evropës

BRUGES, 19 SHKURT (ER) - Pas ndeshjeve në Ligën e Kampionëve, sot (e enjte) zhvillohen ndeshjet në kuadër të 1/16 të finales në Ligën e Evropës. Manchester Unitedi në katër ndeshjet e fundit ka marrë tri fitore, përfshirë edhe atë ndaj Chelseat në Premierë Ligë (0-2). Këtë formë të mirë "Dajtë e Kuq" po synojnë ta vazhdojnë edhe në Ligën e Evropës, ku për kundërshtare e kanë skuadrën e Club Brugge në 1/16 e kësaj gare. Unitedi



TË ENJTEN TAKOHEN:
18:55 CFR Cluj - Sevilla
18:55 Club Brugge - Manchester United
18:55 Eintracht Frankfurt - Salzburg
18:55 København - Celtic
18:55 Getafe - Ajax
18:55 Ludogorets R. - Inter
18:55 Shakhtar Donetsk - Benfica
18:55 Sporting - İstanbul Basakşehir
21:00 APOEL Nicosia - Basel
21:00 AZ Alkmaar - LASK
21:00 Bayer Leverkusen - Porto
21:00 Olympiacos - Arsenal
21:00 Rangers - Braga
21:00 Roma - Gent
21:00 Wolfsburg - Malmö
21:00 Wolverhampton W. - Espanyol

është në garë për pozitat që e dërgojnë në Ligën e Kampionëve, e në FA Cup do të përballet me Derby County. Snim i Unitedit është ta fitojë trofeun e Ligës së Evropës për herë të dytë në tre vjetët e fundit, kurse klub i belg në këtë garë vjen pas dështimit në Ligën e Kampionëve, ku u pozicionua në vendin e tretë në grup pas Real Madridit dhe Paris Saint-Germainit. Ndryshtë nga Liga e Kampionëve, në kampionatin

elitar të Belgjikës Club Brugge është i pari me nëntë pikë me shumë se Genti që zë vendin e dytë. Punë aspak e lehtë e pret Arsenalin, pasi në ndeshjen e parë i shkon në Greqi, Olympiacosit. Interi e Roma nuk pritet të kenë punë të vështirë ndaj Ludogoretsit, përkatësisht Gentit. Një ndeshje e fortë do të zhvillohet në Gjermani, ku Bayer Leverkuseni e pret skuadrën e famshme portugeze, Porto.

Dumoshi: Do ta përkrahim ngritjen e cilësisë në futboll

PRISHTINË, 19 SHKURT - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka pritur në kabinetin e vet drejtuesit e Federatës së Futbollit të Kosovës në krye me kryetarin Agim Ademi. Gjatë këtij takimi u diskutua për zhvillimet në futbollin e Kosovës si dhe për vazhdimin e bashkëpunimit në mes të MKRS-së dhe FFK-së.

Ministria Dumoshi ka thënë se është e interesuar që ta zhvillojë sportin me anë të projekteve të natyrave të ndryshme, të cilat kanë një rëndësi të veçantë për avancimin e mëtejmë të futbollit të Kosovës. "Ju keni arritur të bëni më të mirën për Kosovën, sidomos në futboll, falë punës suaj të palodhshme dhe punës së të ndjerit Fadil Vokri, duke filluar nga pranimi në UEFA e deri te lojërat e fundit të Kombëtares së Kosovës në futboll, me të cilat na bënë krenarë djemtë tanë", u shpreh ajo.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për mbështetjen e MKRS-së për infrastrukturën sportive, ku në



këtë rast ministria u shpreh se është "e interesuar që ta zhvillojë sportin edhe nëpër shkollat e ndryshme të vendit, në kuadër të masivizmit të tij, sepse rinia i duhet vendit tonë, se ajo duhet të qëndrojë në Kosovë". "Prandaj jam e fokusuar që ta zhvilloj sa më shumë infrastrukturën sportive", ka thënë Dumoshi. Ajo shtoi se "ndërtimi i terreneve sportive është lajmi më i mirë për sportin dhe për Kosovën. Bashkë me kryetarët e komunave dhe me ju do të shohim se në ç'fazë janë projektet e kësaj natyre dhe

bashkërisht do të jemi të gatshëm të mobilizohemi dhe t'i realizojmë të gjitha ato nëpër të gjitha komunat e Kosovës". Ndërkaj kryetari i FFK-së, Agim Ademi, e falënderoi ministren Dumoshi për pritjen dhe gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar dhe ndihmuar futbollin në Kosovë. Ademi u shpreh se angazhimi i përbashkët për realizimin e plotë të projekteve infrastrukturore sportive i shërbën dhe është në kontribut të avancimit të futbollit kosovar dhe ngritisë së cilësisë së tij.

SHKURT

Canatar: Muriqi është i lumtur në Fenerbahçe

Menaxheri i Vedat Muriqit, Haluk Canatar, ka hedhur poshtë akuzat se sulmuesi i Kosovës nuk është i lumtur në Fenerbahçe. Sipas tij, Muriqi është i gatshëm që edicionin e ardhshëm të luftojë në Ligën e Kampionëve. "Lidhur me Vedat Muriqin, futbollistik profesionist që unë përfaqësoj, lajmet janë plotësisht të pabazuara që për shkak të ofertave të ardhura së fundmi ai është në dy mendje. Ai është Jashtëzakonisht i lumtur që luan në klubin e tij dhe dëshiron që të arrijë sukses në kampionat dhe për të arritur sukseset të reja në sezoni e ardhshëm dhe të jetë në gjendje të luftojë në Ligën e Kampionëve, ai nuk ka asnjë dyshim", ka thënë agjenti i Muriqit.

Tuchel: Kualifikohemi në Paris

Trajneri i PSG-së, Thomas Tuchel, ishte shumë i zhgënjerës në fund të takimit në humbjen ndaj ish-skuadrës së tij. Ai ka thënë se ekipi vuajti presingun e lartë të kundërshtarit, i cili bëri një ndeshje të mirë. "Luajtëm me një sistem loje, i cili nuk na lejoi të dilnim në lojën tonë. E di që rezultati nuk është ai që dëshironim në fillim të takimit, është e lehtë të thuash se ishte faj ynë. Skuadra të tjera kanë humbur këtu, janë gjëra që ndodhin në një kompeticion të tillë", ka thënë Tuchel. "Do të bëjmë më të mirën tonë në ndeshjen e kthimit. Sigurisht se nuk do të luajmë sikurse në këtë ndeshje. Besoj se gjithçka do të shkojë në favorin tonë. Skuadra i ka të gjitha cilësitë për ta kthyer ndeshjen. Do të provojmë deri në fryshtë e fundit", ka shtuar Tuchel.

Simeone: Fituan një ndeshje të madhe

Diego Simeone është shprehur i lumtur me fitoren e arritur kundër Liverpoolit në ndeshjen e parë në Ligën e Kampionëve. "Fituan një ndeshje të madhe. Jam shumë i kënaqur me paraqitjen që bëri ekipi. E kuptuan se duhet të luajmë vetëm në këtë mënyrë. Jam i lumtur përfunduar përfunduar në spital. Edhe vetë lojtari i dëmtuar është pezulluar përfunduar në spital. Ky i fundit ka bërë 10 qepje dhe ka qëndruar 4 ditë pa shkuan në punë.

Futbollisti pezullohet për 5 vjet pasi kafshoi kundërshtarin në organ gjenital

Një futbollist amator është pezulluar përfunduar në një kampionat rajonal në lindje të Francës pasi ka kafshuar kundërshtarin në organ gjenital, në një sherr që shpërtheu pas ndeshjes. Ngjarja ndodhi më 17 nëntor, në parkimin pranë fushës ku u luajt ndeshja Terville - Soetric. Sipas medieve vendase, dy futbollistë nisën sherrin, e pësoi më keq ai që u fut përfunduar në spital. Edhe vetë lojtari i dëmtuar është pezulluar përfunduar në spital. Ky i fundit ka bërë 10 qepje dhe ka qëndruar 4 ditë pa shkuan në punë.

Wilder: Fury nuk di të godasë

Deontay Wilder ka lëshuar disa deklarata të zjarrta para përballjes së tij kundër Tyson Furyt këtë të shtunë pas mesnate. Të dy boksierët do të ndeshën përfunduar në një-tjetrin, pas mësimeve të parë që u nda në barazim. Në një intervistë para kësaj superpërballje, Wilderi deklaroi se do ta moshtë Furyn, pasi ky i fundit nuk di të godasë. "Fury, doja ta thosha këtë edhe mi herët, i ka grushtet e butë si jastëk. Kjo është arsyja se unë jam i aftë ta aplikoj presionin mbi të", u shpreh 34-vjeçari përfunduar "Sky Sport". "Fury nuk di të godasë. Grushtet e mi kur isha dyvjeçar ishin më të fortë se të tij tanë", ka përfunduar ai. Mbrëmja e së shtunës pritet të dhurojë spektakël në ring, pasi të dy luftëtarët janë në një formë të shkëlqyeshme dhe do ta diskutojnë titullin e kampionit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave /
Ministry of Internal Affairs and Public Administration



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Në pajtim me Ligjin e punës Nr. 03/L-212 kreu II, neni 8, Ligjin për Policinë Nr. 04/L-076, kreu V, Neni 44 i këtij ligji, Udhëzimin Administrativ 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, Kreu III, Neni 5, paragrafi 2/2, Policia e Kosovës:

U skladu sa Zakonom Rada Br. 03/L-212 poglavje II, član 8, Zakona o Policiji Br. 04/L-076, poglavje V, Član 44 ovog Zakona, Administrativnim Uputstvom 02/2018 o radnom odnosu u Policiji Kosova, Poglavlje III, Član 5, stav 2/2, Policia e Kosovës:

VAZHDON AFATIN E KONKURSIT

Referenca: 07/1-01SAP-R/13/20

Policia e Kosovës vazhdon afatin e konkursit edhe për shtatë (7) ditë për pozitën:

1. Teknik medicinal (katër vendë të lira punc)

Ky konkurs vazhdohet nga data **18.02.2020** deri me **24.02.2020** për shkak të mosarritjes të një numri të balancuar të aplikacioneve nga aspekti etnik.

Për çdo informacion mund te kontaktoni Sektorin e Rekrutimit dhe Seleksionimit, nr. tel. 038 245184

PRODUŽUJE ROK KONKURSA

Referenca: 07/1-01SAP-R/13/20

Policja Kosova produžuje rok konkursa za još sedam (7) dana za položaj:

1. Medicinski tehničar (çetiri slobodna radna mesta)

Ovaj konkurs se produžuje od **18.02.2020** do **24.02.2020** zato što nije postignut balansiran broj aplikacija na ctničkom aspektu.

Za svaku informaciju možete kontaktirati Sektor Regrutacije i Selekcije na broj tel. 038 245184



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

NJ O F T I M

ANULOHET konkursi për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSHV) e publikuar nga

Zyra e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport me datë 25 janar 2020.

Anulimi bazohet në vendimin e Qeverisë Nr.02/02 të datës 12.02.2020.

Nga pjesëmarrësit në konkurs kërkojmë mirëkuptim.

OBAVEŠTENJE

OTKAZAN je konkurs Sporazuma za posebne usluge (SPU) objavljen od strane Kancelarije

nacionalnog koordinatora za kulturu, omladinu i sport dana 25. januara 2020.

Otkazivanje se temelji na Odluci Vlade br. 02/02 od 12.02.2020.

Od učesnika konkursa tražimo razumevanje

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Fakulteti Juridik

Studimet e Doktoratës

Prishtinë, me 19.02.2020

Në bazë të nenit 127, al.1, të Statutit të Universitetit të Prishtinës " Hasan Prishtina", nenit 17, al 2 dhe 4 të Rregullores mbi studimet e doktoratës, vendimit të Këshillit të i Fakultetit Juridik të datës 12.04.2019 me numër protokoli nr.02/91 dhe vendimit për ratifikim nga Senati i Universitetit të Prishtinës, të datës 11.02.2020 me numër protokoli 369, kandidates Ma.Sc. Mirvete Uka i është lejuar mbrojtja publike e disertacionit të Doktoratës, andaj mbi bazën e dispozitave të cekura më lart, bëjmë këtë

NJOFTIM

Me të cilin njoftojmë të gjithë të interesuarit se me datën 28.02.2020, me fillim në ora 12.00 në ambientet e fakultetit Juridik, kandidatja Mirvete Uka, për të fituar titullin Doktor i Shkencave Juridike nga fusha penale, bënë mbrojtjen publike të disertacionit me titull: *Gjykimi i drejtë në procedurë penale dhe ndikimi i parimit të publicitetit në gjykimin e drejtë*, para komisionit profesional në përbërje prej:

1. Prof.Dr.Rexhep Gashi (Kryetar),
2. Prof.Dr.Azem Hajdari (anëtar) dhe
3. Prof.Dr.Ismail Zejneli (anëtar i jashtëm) nga Fakulteti i Drejtësisë – Universiteti i Evropës Juglindore në Republikën e Maqedonisë së Veriu.

Prishtinë, me 19.02.2020

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime
drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/giejpuneshpeite

C.nr. 1644/12

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtaren, Naime Ahmeti, në çështjen juridike të paditësit Donat Lushaku nga Prishtina, Rr. Rifat Berisha, objekti 11, kati I, banesa nr. 1, të cilin e përfaqëson Maliq Lushaku, sipas autorizimit, kundër të paditurit Jetullah Mehmeti nga Prishtina, Lagja Matiqan, përvërtetimin e posedimit, në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes në prani të autorizuarit të paditësit, e në mungesë të paditurit, me dt.07.09.2017, mori këtë :

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e pabazuar kërkesëpacia e paditësit Donat Lushaku nga Prishtina, dhe VËRTETOHET se paditësi në bazë të kontratës mbi shitblerjen datë 03.09.2010, është posedues i banesës e cila gjendet në Prishtinë, Lagja Kodra e Diellit II, Rruga Rifat Berisha, objekti 11, kati përdhese, banesa nr.1, në sipërfaqe prej 45 m², e cila evidentohet në qertifikatën e pronësisë me nr. 0-71914059-10012-0741-0 ZK Prishtinë, e cila në Drejtoreni për Kadastër në Komunën e Prishtinës, nuk ka të evidentuar pronar.

II.Ky aktgjykim do të shërbej si titull juridik për regjistrimin e posedimit në regjistrat e palujshmërive në Drejtoreni për Pronë dhë Kadastër të Komunës së Prishtinës, në emër të paditësit si në pikën I të këtij dispozitivi.

III. Të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësi nëpërmes të autorizuarit të tij në padi, në seancat e mbajtura dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, ka theksuar se banesën lëndore e ka blerë në vitin 2009, sipas kontratës së shitblerjes të palujshmërisë të dt. 03.09.2010, e lidhur ndërmjet shështë Jetullah (Mehmet) Musliu nga Prishtina, në njëren anë dhe blerësit Donat Lushaku nga Prishtina, në anën tjetër, të banesës e cila gjendet në Prishtinë, Lagja Kodra e Diellit II, Rruga Rifat Berisha, objekti 11/3, në sipërfaqe prej 45 m², të cilën e ka blerë në shumë prej 23,850.00 €, që paditësi ia pagoi në tërësi të paditurit, dhe ka hy në posedim, mirëpo ka theksuar se këtë kontratë nuk e kanë vërtetuar në gjykatë, por është e vërtetuar deklaratë dëshmia e të paditurit me Vr.nr.3844/12 dt.25.05.2012, ku deklaron se pronësinë-banesën të cilën ia ka shitur paditësit, e kam në pronësi që nga viti 1990 dhe mbi bazën e shfrytëzimit mbi 20 vite e ka fituar të drejtë mbi të, mirëpo nuk ka qenë i regjistruar si pronar në regjistrin e palujshmërive pranë Komunës së Prishtinës. Fillimisht paditësi me padi ka kërkuar vërtetimin e pronësisë mbi banesën lëndore të cekur më lartë, mirëpo me parashtrësën e dt. 11.08.2016, ka ndrua bazën juridike të padisë duke theksuar se tani baza juridike është vërtetimi i të drejtës së posedimit në palujshmëri, dhe se në rastin konkret kemi të bëjmë me padi posedimore, ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, e ka precizuar kërkesë padinë, vërtetimi i posedimit të banesës objekti 11, hyrja 1, banesa nr. 3, e cila gjendet në rrugën Rifat Berisha, në sipërfaqe prej 45 m², e evidentuar dhe regjistruar në Komunën e Prishtinës pa pronar, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesë padia si e bazuar pasi që edhe posedimi gjëzon mbrojtje gjyqësore, pasi që paditësi ka pushtetin faktik, e ka në posedim të drejtë dhe të ligjshëm dhe me të drejtë është konstituar e drejta e posedimit në kuptim të dispozitave të nenit 36, 103 dhe 104 të PDTs. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Përgjigje në padi nuk ka pas.

I padituri Jetullah Musliu ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e shqyrtimit kryesor dhe seancat e mbajtura, mirëpo i njejtë nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyuar, me propozimin e përfaqësuesit të palës paditëse, gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 423.4 të LPK-së, i ka mbajt shqyrtimin kryesor në mungesë të paditurit.

Gjykata në kuptim të nenit 8 të LPK-së, bëri analizimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe erdhë në përfundim se padia e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka marrë përbazë parashtrimet e të autorizuarit të paditësit në procedurë dhe shkresat e lëndës si, Kontrata mbi shitblerjen e palujshmërisë e dt. 03.09.2010, deklaratë dëshmia e dhënë nga i padituri Jetullah Musliu, me VR.nr.3844/12 e dt. 25.05.2012 dhe ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë Lulzim Dema e dt. 05.06.2017.

Pasi që objekt i kontestit në këtë çështje juridike është vërtetimi i posedimit, gjykata e ka aprovar propozimin e të autorizuarit të paditësit për caktimin e ekspertizës nga lëmia e ndërtimtarisë, të cilin gjykata ia ka dhënë autorizimet që i njëjti të kërkoi edhe për historiat e banesës lëndore pranë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Prishtinës.

Në bazë të ekspertizës së ekspertit të ndërtimtarisë të përpiluar me dt. 05.06.2017, del se kemi të bëjmë me banesën e cila gjendet në Prishtinë, Lagja Kodra e Diellit II, Rruga Rifat Berisha, objekti nr. 11, hyrja 1, banesa nr. 1, e cila gjendet në katin përdhesë, në sipërfaqe prej 45 m², në të cilën përmomentin jeton Donat Lushaku. Në bazë të faturave të rrymës dhe të ujë të prezantuara nga si në ekspertizë, rrijedhë se numri i banesës është nr. 3, kurse në evidence e Komunës së Prishtinës, nga Kadastr, banesa është e shënuar me nr. 1 dhe sipas organeve komunale nuk ka pronar të evidentuar në banesën nr. 1 dhe në banesën nr. 4, ashtu

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Gentrit Kadriu shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit me nr personal:
1176702709 me nr. te biznesit
810910613 Skenderaj.**

**Kërkoj kujdestare përvajzën 7 muajshe në Prishtinë.
Për informata në tel: 044-444-009**

- Elfije Tahiraj shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesën e shkollës së mesme tehnike "Anton Çetta" Skenderaj
- Brahim Musaj B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 601552913
- Burim Llutaj shpall te pavlefshme certifikatën e furritarit 30.01.2018 instituti Dituria Prizren.
- Zecir Murati shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën certifikatën shme "Ymer Prizreni" Prizren.
- Murat Kadriaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.
- Artan Mazrek shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Brigada 125" Medvec.
- Arian Gavazaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Dëshmoret e Zhurit" Zhur.
- Elif Hoxhaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Emin Duraku" Prizren.
- Fadil Buqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Emin Duraku" Prizren.
- "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr. Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditore se ka marre vendim për zgogëlimin e kapitalit themelor, zgogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillojat 50000 (pesëdhjetë mijë) në 5000 Euro.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhammed Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, katër dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.

- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhammed Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², katër dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

- Lëshoj banesë me qira gjarsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merrë për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentish kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalë më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj lokalë më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", katër tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



The banner features the RC Cola logo at the top left, followed by a large yellow box containing the text "ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS". Below this, a blue box lists "Quality & Sales Award Recipients" in alphabetical order. To the right, there are images of a blue can and a dark plastic bottle of RC Cola.

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- ★ Fludi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



The advertisement features a tin of Meka Halal Food Pashtetë Pule. The tin is orange with a white lid, showing a slice of the pate with herbs and a red pepper. Text on the tin includes "MEKA HALAL FOOD", "PASHTETË PULE", "gluten free", "100 % mish puk", "cili e garantuar!", and "pa konservues". The background is orange with white, flame-like streaks.